

MBI
AUDITIMIN E USHTRUAR NË
BASHKINË SARANDË

Raporti Përfundimtar i Auditimit të kryer në **Bashkinë Sarandë**, me objekt: “*Mbi auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, lloji i auditimit: “*Për auditimin e ligjshmërisë dhe rregullshmërisë financiare*”, për periudhën e veprimtarisë 01.01.2012 deri 31.12.2013 dhe masat për përmirësimin e gjendjes, janë miratuar me vendimin e Kryetarit të KLSH nr. 140, datë 30.09.2014.

Bazuar në nenet 9 dhe 16 të ligjit nr. 8270, datë 23.12.1997 “*Për Kontrollin e Lartë të Shtetit*”, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 8599, datë 01.6.2000, Kontrolli i Lartë i Shtetit me shkresën nr. 454/10, datë 30.09.2014, i ka rekomanduar z. Stefan Çipa, Kryetar i Bashkisë, zbatimin e masave të mëposhtme:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.Gjetje nga auditimi:Nuk janë zbatuar plotësisht rekomandimet e dërguara në vitin 2013 nga KLSH për 37 masa për shpërbllim dëmi në vlerën prej 70,320,778 lekë dhe 6 masa administrative në vlerën prej 600,000 lekë (*gjithsej 70,920,778 lekë*), deri në momentin e auditimit është arkëtuar vetëm shuma 1,092,574 lekë, dhe mbeten pa arkëtuar vlera 69,228,204 lekë.

1.1 Rekomandim: Të merren të gjitha masat dhe të kryhet rivlerësimi i rekomandimeve të lëna nga KLSH me shkresën nr. 941/19, datë 31.12.2013, protokolluar në Bashkinë Sarandë me nr. 1762/9, datë 08.01.2013.

Menjëherë

2.1 Gjetje nga auditimi:Nuk janë zbatuar kërkesat të ligjit nr. 10926, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, (MFK) pasi nuk është hartuar plani për ngritjen e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, si dhe metodologjia për zbatimin e tij, nuk janë përfshirë procedurat antikorrupsion, nuk është hartuar dhe miratuar Kod Etik.

2.1 Rekomandim: Titullari i njësisë publike, Bashkia Sarandë, të marrë masa që të zbatojë menaxhimin financiar dhe kontrollin nëpërmjet komponentëve të ndërlidhur me njëri tjetrin: mjedisi i kontrollit, menaxhimi i riskut, veprimtaritë e kontrollit, informacioni dhe komunikimi si dhe monitorimi.

Vijimësi

3.1 Gjetje nga auditimi:Nuk janë zbatuar kërkesat të ligjit nr. 10926, datë 08.07.2010 “*Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin*”, lidhur me ngritjen e strukturës për kontrollin e brendshëm dhe përputhshmërisë së strukturës me aktet e tjera që rregullojnë funksionimin e institucionit.

3.1 Rekomandim: Titullari i njësisë publike, Bashkia Sarandë, të marrë masa për të bërë ndryshimin e rregullores së brendshme në përshtatje me kërkesat e MFK dhe në përputhje me strukturën organike të NJQV me qëllim që, të mos ketë ndryshime midis strukturave të përcaktuara sipas organikës me ato të përcaktuara në rregullore.

Menjëherë

4.1 Gjetje nga auditimi:Nga struktura e auditit të brendshëm në Bashkinë Sarandë, nuk janë programuar dhe vlerësuar fushat që paraqesin risk për auditim dhe nuk është vepruar mbi bazën e programeve të punës që mundësojnë kryerjen e auditimeve me cilësi.

4.1 Rekomandim: Njësia e Auditit të Brandshëm të programojë misione/angazhime në funksion të analizës dhe vlerësimin e riskut. Njësia e auditit të hartoj dhe të mbaj një program që të

siguroj cilësinë e auditimeve të kryera dhe të vlerësoj veprimet e njësisë së auditimit të brendshëm sipas standardin 1310 të IIA-së.

Vijimësi

5.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Shërbimeve janë hartuar e miratuar preventiva me zëra punimesh më tepër se sa parashikuar nga VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”, duke sjellë për pasojë preventiva jo real, fond më të madhë se nevoja për investim, dhe përfitim të padrejtë për shoqëritë sipërmarrëse.

5.1 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve në përgatitjen e projekteve e preventiva të investimeve që duhet të kryej të veprohet në zbatim të akteve ligjore rregullatore të cilat janë në fuqi në kohën e përpilimit të dokumentacionit apo në kohën e realizimit të investimit në rastet kur kryerja e këtyre dy procedurave nuk përkohet në kohë apo kur nga njëra procedurë në tjetrën është konstatuar ndryshim i kuadrit ligjor të fushës.

Vijimësi

6.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Shërbimeve në hartimin dhe miratimin e projektbuxhetit lidhur me kërkesat për mallra, pune apo shërbime nuk janë marrë parasysh nevojat reale, pasi nuk janë hartuar mbi bazën e projekteve të bërë nga specialistët përkatës, duke sjellë për pasojë kërkesa jo sipas nevojës dhe buxhet për investime i cili nuk përmbush misionin e njësisë së qeverisjes vendore.

6.1 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve të marrë masat e duhura duke siguruar një vlerësim më real të nevojave për mallra, punë dhe shërbime dhe të sigurojë se prioritet për blerje janë vendosur sipas këtyre nevojave. Specialistët e fushës duhet të përfshihen në të gjitha fazat e vlerësimit të nevojave dhe përcaktimit të specifikimeve teknike.

Vijimësi

7.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Shërbimeve në hartimin dhe miratimin e projekteve dhe preventivave për mallra, punë dhe shërbime shpesh nuk janë bazuar në aktet ligjore në fuqi, duke mos u dokumentuar nga autoriteti kontraktor në se janë kryer analizat e kostos së mallrave që do të prokurohen krahasuar me specifikimet teknike, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

7.1 Rekomandim: Drejtoria e Shërbimeve të marrë masat e duhura lidhur me studimin e vlerësimit të kontratës duke harmonizuar metodat e vendosura në aktet ligjore e nënligjore të prokurimeve si çmimet e botuara nga INSTAT-i, çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj.), çmimet e tregut apo dhe çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë institucioni apo nga autoritete të tjera kontraktore.

Vijimësi

8.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Shërbimeve dhe Njësia e Prokurimit por dhe strukturat e tjera përgjegjëse pranë bashkisë në parashikimin e nevojës për prokurimi, kërkesën për prokurim dhe miratimin e saj dhe më tej në hartimin dhe miratimin e urdhrat për zgjedhjen e procedurës së prokurimi, ngritjen e komisionit të vlerësimit, fondit limit dhe specifikimet teknike; përgatitjen, miratimin dhe hedhjen në sistem të dokumenteve të tenderit; ngritjen e komisionit dhe vlerësimit të ofertave; përgatitjen, miratimin, nënshkrimin e kontratës, mbikëqyrje e zbatimit të kontratës, kolaudimin dhe marrjen në dorëzim e punimeve, mallrave dhe shërbimeve, dhe deri në veprimin final të likuidimit të transaksioneve dhe zbatimin e detyrimeve

kontraktuale nuk është vepruar në përputhje me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

8.2 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Shërbimeve, Drejtoria Ekonomike, Njësia e Prokurimit, por sipas rastit dhe struktura të tjera përgjegjëse në autoritetin kontraktor të forcojnë kontrollin e brendshëm në lidhje me procedurat e planifikimit dhe prokurimit, si dhe të dokumentojnë mënyrën e marrjes së ofertave nga operatorët ekonomik për studimin e tregut dhe përcaktimin e vlerës limit të kontratës, si dhe të zbatojnë e dokumentojnë të gjitha hapat deri në likuidimin e çdo kontrate për mallra, punë dhe shërbime.

Vijimësi

9.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, për 10 raste të përzgjedhjes së procedurës së prokurimit “me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës” është bërë në kundërshtim me LPP, neni 33 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu IV, pika 5, për arsye se dështimi i procedurave të hapura në të gjitha rastet ka rezultuar për shkak të kriterëve të veçanta për kualifikim, të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës, dhe kanë çuar në skualifikimin e OE për mosplotësim të këtyre kriterëve.

9.2 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Shërbimeve dhe Njësia e Prokurimit, të përdorin vetëm për raste të veçanta procedurën “me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës”, pasi me ndjekjen e zbatimit e kësaj procedure dhe jo me procedurën “e hapur”, autoriteti kontraktor, në mungesë të konkurrencës nuk arrin të realizojë plotësisht nevojat për mallra, punë e shërbime në sasi por me të njëjtat ose më pak burime, si dhe duhet të merren gjithashtu në konsideratë **ekonomiciteti, eficienta** dhe efektiviteti në zhvillimin e procedurave të prokurimit, si detyrë e njësive të qeverisjes vendore.

Vijimësi

10.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore nuk është përmbushur funksioni dhe misioni i saj lidhur me përlogaritjen dhe vjeljen e detyrimeve tatimore ndaj 2093 subjekteve të cilat ushtrojnë aktivitetin në territorin administrativ të kësaj njësie të qeverisjes vendore, në kundërshtim me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dalë në zbatim.

10.2 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të merren masa për vjeljen e detyrimeve tatimore të papaguara nga 2093 subjekte tatimpaguese në **shumën 79,311,473 lekë**, të ndarë në vite si vijon:

- për 1202 subjekte fizike e juridike në vlerën 75,707,033 lekë
- për 77 subjekte tregu në vlerën 558,203 lekë.
- për 814 subjekte të tokës bujqësore në vlerën 3,046, 237 lekë

Vijimësi

11.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore nuk është përmbushur funksioni dhe misioni i saj lidhur regjistrimin në QKR të subjekteve tregtare, si dhe nuk është aplikuar ndaj tyre neni 112 i ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore”.

11.2 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të merren masa për të regjistruar në QKR, 622 subjekte të cilat rezultojnë se ushtrojnë rregullisht aktivitetin tregtar pa qenë të regjistruar, dhe të aplikojnë ndaj tyre sanksione duke vendosur gjobë në masën 25,000 lekë.

Menjëherë

12.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore nuk është përmbushur funksioni dhe misioni i saj lidhur planifikimin sa më real të të ardhurave, pasi rezulton se realizimi i tyre më i vogël se parashikimi.

12.2 Rekomandim: Nga Këshillit Bashkiak Sarandë dhe Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të analizohen e të planifikohen të ardhura të cilat nuk janë planifikuar nga kjo drejtori me qëllim rritjen e tyre dhe përmirësimin e shërbimeve nga njësia e qeverisjes vendore.

Vijimësi

13.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore nuk është kërkuar vendosja e barrës siguruese, në Drejtorinë Rajonale të Transportit Sarandë (për mjetet) si dhe nuk është kërkuar vendosja e gjobave sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat tatimore”.

13.2 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të kërkohet të bashkëpunohet me në Drejtorinë Rajonale të Transportit Sarandë lidhur me vendosjen e barrës siguruese për mjetet si dhe për tatimpaguesit që nuk shlyejnë detyrimet në afat të vendoset gjobë në masën 5-25% të detyrimit.

Menjëherë

14.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore nuk është kërkuar nga Këshilli Bashkiak ndërhyrja me forcë e Policisë Bashkiake për vjeljen e subjekteve debitoare sipas nenit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

14.2 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të kërkohet në mbledhjen e radhës të Këshillit Bashkiak Sarandë, analizimi dhe vlerësimi i gjendjes të subjekteve debitorë ndaj Bashkisë Sarandë duke kërkuar ndërhyrjen me forcë të organit të Policisë Bashkiake, me qëllim vjeljen e detyrimeve nga këto subjekte.

Menjëherë

15.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore është vepruar me përlllogaritjen e detyrimeve të subjekteve kur konstatohet se dosjet e tyre paraqesin mangësi kryesisht lidhur me certifikatat apo vërtetimet e pronësisë mbi pronën dhe sipërfaqen funksionale në të cilën ato ushtrojnë aktivitetin, në kundërshtim me nenit 24, të ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

15.2 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore në bashkëpunim me strukturat e tjera të njësisë vendore të ngrihet një komision i posaçëm me qëllim të verifikimit dhe saktësimit të sipërfaqes të pronësisë për çdo subjekt dhe mbi bazën e këtyre të dhënave të përlllogariten detyrimet për taksën e ndërtesës.

Menjëherë

16.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore nuk është bashkëpunuar me strukturat e tjera të njësisë vendore lidhur me ndjekjen dhe detyrimin e subjekteve debitorë për detyrimet fiskale që lindin nga taksa e regjistrimit, si dhe ka munguar rakordimi i dy strukturave veprim i cili ka mundur fshirjen apo zvogëlimin e detyrimeve ndaj subjekteve debitoare.

16.2 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore të dërgohet periodikisht në Drejtorinë e Financës pranë njësisë vendore, lista e debitorëve për detyrimet fiskale për taksën e regjistrimit të tyre, si dhe periodikisht të bëhet ndjekja dhe rakordimi i tyre.

Menjëherë

17.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore nuk janë përmbushur detyrimet ligjore për ushtrimin e kontroleve sipas pikës 10 “Kontrolli tatimor”, të Udhëzimit përbashkët të MB dhe MF nr. 655/1, datë 6.02.2007.

17.2 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Taksave e Tarifave Vendore. Të merren masa dhe të planifikohen periodikisht kontrole tatimore në terren, me qëllim shmangien dhe eliminimin e ushtrimit të aktivitetit tregtar nga subjekte të palicencuar apo ushtrimit të aktivitetit në tejkalim të licencës së dhënë dhe mbi sipërfaqen e tatueshme.

Menjëherë

18.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Personelit nuk janë zbatuar procedurat ligjore lidhur me hartimin e kontratave të punës të punonjësve të policisë bashkiake dhe konkretisht të nenit 4, 5 dhe 7 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës” dhe Kreut III të neni 11, pikat 7, të Urdhrit i Përbashkët i MPV dhe MRP nr. 1, datë 01.01.2003”.

18.2 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Burimeve Njerëzore dhe Personelit, për të gjithë punonjësit e policisë bashkiake të ngrihet komision i posaçëm për marrjen dhe emërimin e tyre në punë, si dhe hartimi i kontratave individuale të punës të bëhet sipas akteve ligjore të mësipërme.

Menjëherë

19.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Policia Bashkiake nuk janë zbatuar kërkesat e ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997, “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës” lidhur me arkëtimin e gjobave të vendosura si dhe kontabilizimin e tyre.

19.2 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Policia Bashkiake dhe Drejtoria e Financës të bashkëpunohet duke krye akte rakordimi periodik lidhur me sasinë e fletëve të gjobave të furnizuara, sasinë e gjobave të vendosura, arkëtimet e realizuara dhe kontabilizimin e tyre.

Vijimësi

20.1 Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 480, datë 22.6.2011, “Për miratimin e rregullores model të planifikimit” e ndryshuar, neni 10, pika 11 e cila përcakton se Infrastruktura e nevojshme që mundëson funksionimin e një zhvillimi të ri dhe e lidh zhvillimin e ri me rrjetet ekzistuese të infrastrukturave, realizohet nga zhvilluesi dhe leja e përdorimit jepet vetëm pasi kjo infrastrukturë regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi”, pasi nuk ka certifikatë apo vërtetim pronësor të lëshuar nga ZVRPP Sarandë.

20.2 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për çdo rast, përpara lëshimit të lejes së përdorimit të shqyrtohet e vlerësohet nëse nga subjekti është përmbushur kriteri ligjor lidhur me regjistrimin e infrastrukturës në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme të ZVRPP Sarandë.

Vijimësi

21.1 Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, para lëshimit të lejeve të përdorimit nuk ka kërkuar nga çdo subjekt ndërtues plotësimin me dokumentacion të dosjes së lejes së zhvillimit të miratuar më parë me vendim të KRRT Bashkia Sarandë, vendime të marra sipas ligjit të kohës nr. 8405, datë 17.9.1998 “Për Urbanistikën” dhe VKM nr. 722, datë 19.11.1998 “Për miratimin e Rregullores së Urbanistikës”.

21.2 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për çdo rast, përpara lëshimit të lejes së përdorimit të shqyrtohet e vlerësohet nëse subjekti ka të plotësuar të

gjithë dokumentacionin e praktikës së lejes së përdorimit, kjo si për dosjet e trajtuar me mangësi në këtë projektraport auditimit ashtu dhe për ato që paraqiten në të ardhmen.

Vijimësi

22.1 Gjetje nga auditimi: Nga Drejtoria e Planifikimit të Territorit, para lëshimit të lejeve të përdorimit nuk është kërkuar nga Inspektorati Ndërtimor Urbanistik Vendor pranë Bashkisë Sarandë, nëse subjekti ndërtues ka apo jo detyrimeve të pashlyera apo nëse ndaj tij është proceduar me sanksione të cilat janë në proces apo ende të përfunduara.

22.2 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Planifikimit të Territorit, për çdo rast, përpara lëshimit të lejes së përdorimit të kërkohej zyrtarisht nga INUV Bashkia Sarandë për aktet e mbajtura me subjektin përkatës si dhe nëse rezulton se ka detyrime të pashlyera ndaj kësaj strukture.

Vijimësi

23.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë nuk është kryer një proces i saktë e përfundimtar i inventarizimit të aseteve të Bashkisë Sarandë, pasi rezulton se ka mjaft pasaktësi në drejtim të regjistrimit të pasurive të cilat nuk janë të pasqyruara në listën e inventarit apo të cilat rezultojnë në të por nuk ekzistojnë fizikisht, në kundërshtim me ligjin nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe VKM nr. 500 datë 14.08.2001, si dhe nuk është bërë kontabilizimi dhe regjistrimi në ZVRPP Sarandë, sipas nenit 7, të ligjit nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, ligjit nr. 10296, datë 08.7.2010, “Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin”, pikës 74, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik” dhe pikës 21, të VKM nr. 500, datë 14.8.2001 dhe ligjit nr. 33/2012, datë 29.4.2012 “Për Regjistrimin e Pasurive të Paluajtshme”.

23.1 Rekomandim: Titullari i njësisë publike, Bashkia Sarandë, të marrë masa dhe të ngre grup pune për kryerjen e një inventarizimi sa më real të aseteve si përsa i përket numrit dhe sipërfaqes së tyre, ashtu dhe gjendjes fizike (për objektet), me qëllim miratimin nga Këshilli Bashkiak e më tej nga Këshilli i Ministrave të inventarit real të tyre, por dhe miradministrimin, mirëmbajtjen dhe nxjerrjen e të ardhurave prej tyre, në ato raste kur është e mundur vënia e tyre në përdorim nga subjekteve private. Gjithashtu të parashikohet në buxhet fond për aplikim në ZVRPP për regjistrimin e trojeve e objekteve të kaluara në pronësi.

Menjëherë dhe Vijimësi

24.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë nuk është vepruar me miratimin apo dhënien e pëlqimit nga Këshilli Bashkiak të praktikave të dhënies me qira të aseteve në pronësi apo përdorim të njësisë vendore, si dhe për çdo dosje të dhënin me qira të tyre janë konstatuar mangësi të theksuar të njohjes dhe zbatimit të kuadrit ligjor të fushës, pasi dosjes paraqesin mangësi si në administrimin e dokumentacionit ashtu dhe në ndjekjen e procedurave, në kundërshtim me ligjin nr. 7850, datë 29.7.1994 “Kodi Civil”, VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullor”, VKM nr. 632, datë 11.6.2009 “Për miratimin e tarifave të përdorimit të kullotave dhe livadheve shtetërore për kullotje dhe kositje”, si dhe UMF nr. 1, datë 23.5.1995 “Për kriteret teknike të klasifikimit të kullotave, të livadheve dhe procedurat për dhënien e tyre për kullotje e kositje bari”.

24.1 Rekomandim: Titullari i njësisë publike, Bashkia Sarandë, të marrë dhe të ngre grup pune për plotësimin me dokumentacionin tekniko-ligjor të secilës praktike të dhënies me qira, si për trojet e lira, objektet apo të kombinuara, vendstrehimet ashtu dhe për fondin pyjor e kullor si dhe për çdo rast të bëhet miratimi apo pëlqimi i dhënies me qira nga Këshilli Bashkiak.

Menjëherë dhe Vijmësi

25.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë në hartimin e kontratës nr. *ska*, datë 15.03.2012, ***“Për dhënien me qira të objektit Lokal Riviera”***, me palë qiradhënëse Bashkinë Sarandë, dhe me palë qiramarrëse A.G. etj dhe objekt kontrate dhe qëllim përdorimi *“Bar”*, është konstatuar se edhe pse çmimi për m^2 është jo më pak se 150) lekë/ m^2 në muaj”, bashkia e ka lidhur atë me çmim 100 lekë m^2 në muaj pra më pak me 50 lekë/ m^2 në muaj, duke shkaktuar edhe një ekonomik prej 225,600 lekë, si dhe nuk janë kryer procedurat për dhënien e saj me qira, në kundërshtim me VKM nr. 529, datë 08.6.2011 ***“Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”***. Trajtuar më hollësisht në faqet 222-227 të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

25.1 Rekomandim: Titullari i njësisë publike, Bashkia Sarandë, të ngre grup pune për dhënin me qira me ankand të objektit dhe sipërfaqes funksionale të tij, përfshirë këtu edhe tarracën në katin e sipërm, (me kontratë sezonale) dhe pas kryerjes të këtyre procedurave të procedoj me hartimin dhe nënshkrimin e kontratës të re.

Menjëherë

26.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë në hartimin e kontratës nr. *ska*, datë 01.05.2011, ***“Për dhënien me qira të objektit Pontili i ri”***, me palë qiradhënëse Bashkinë Sarandë, dhe me palë qiramarrëse B.B. dhe objekt kontrate sipërfaqen prej 1400 m^2 truall i lirë dhe qëllim përdorimi *“Lokal Shërbimi”*, me çmim prej 140,000 lekë, lidhur kontrata për 20 vite, për të cilin është konstatuar se sipas planimetrisë së sheshit të dhënë me qira, të hartuar nga bashkia, sipërfaqja që përdor subjekti qiramarrës me sipërfaqen që ai realisht disponon është shumë e madhe, pasi nuk janë përfshirë 2 parcela në të cilat ky subjekt ofron shërbimin, të cilat përafërsisht rezultojnë të jenë mbi 500 m^2 , nga ku mbi gjysma rezulton sipërfaqe e ndërtuar. Mosllogaritja e kësaj sipërfaqe ka sjellë për pasojë jo vetëm moszbatim të VKM nr. 529, datë 08.6.2011, por dhe një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Sarandë e cila në këtë fazë të auditimit llogaritet në 900,000 lekë në vit dhe për tri vite është 27,000,000 lekë.

26.1 Rekomandim: Titullari i njësisë publike, Bashkia Sarandë, të ngre grup pune për llogaritjen dhe saktësimin e plotë të sipërfaqes të objektit dhe truallit të lirë funksional të tij, të miratojë në këshillin bashkiak dhënien me qira dhe periudhën për të cilën do të lidhet kontrata dhe pas kryerjes të këtyre procedurave të procedoj me hartimin dhe nënshkrimin e kontratës të re.

Menjëherë

27.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, nga mos aplikimi i VKM nr. 280, datë 15.01.1996, ndryshuar me VKM nr. 1001, datë 13.11.2013 si dhe nr. 529, datë 08.6.2011 e më parë VKM nr. 1712, datë 24.12.2008, ka sjellë të ardhura të munguara në vlerën prej 8,528,400 lekë pasi nga 81 vendstrehime, 20% e tyre ose përafërsisht 4738 m^2 x 75 lekë/ m^2 x 12 muaj = 4,264,200 lekë vetëm për vitin 2012 dhe po kjo vlerë për vitin 2013, kjo pasi sipas deklarimit me shkrim të punonjësve të kësaj njësie vendore rezulton se objektet janë të zëna nga qytetarët dhe janë në përdorim të lirë të tyre. Vetëm përse i përket 5% të vendstrehime që aktualisht përdoren nga privatë, pa kontrata qiraje, pra në mënyrë të jashtëligjshme 5% e sipërfaqe është 1184 m^2 x 75 lekë/ m^2 x 12 muaj = 1,065,600 lekë vetëm për vitin 2012 dhe po kjo vlerë për vitin 2013. Në total për të dy vitet së bashku të ardhurat e munguara janë 2,131,200 lekë. Mos aplikimi i kontratave të qirasë, në kushtet kur me hyrjen në fuqi të VKM nr. 1001, datë 13.11.2013, bën që të ardhurat e munguara të jenë dyfish më të larta se gjatë viteve të mëparshme.

27.1 Rekomandim: Titullari i njësisë publike, Bashkia Sarandë, të ngre grup pune për saktësimin e të gjitha vendstrehimeve ekzistuese në territorin në administrim të njësisë, dhe pas saktësimit

të statusit dhe gjendjes fizike të tyre, të miratojë në këshillin bashkiak dhënien me qira dhe periudhën për të cilën do të lidhet kontrata dhe pas kryerjes të këtyre procedurave të procedoj me hartimin dhe nënshkrimin e kontratës së qirasë për ato objekte që janë në përdorim të të tretëve pa pasur një marrëdhënie kontraktore.

Menjëherë

28.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, nuk është përfshirë në listën e aseteve, trualli prej 400 m², kaluar në pronësi të njësisë vendore sipas Aktmarrëveshjes nr. 339, datë 16.02.2012 të nënshkruar nga Kryetari i Bashkisë, Drejtori Ekonomik dhe Drejtori Juridik, në cilësinë e palës përfituese dhe Romeo Shito, blerës, për të cilën është rënë dakord për zgjidhjen e kontratës datë 18.10.2004 e lidhur nga Bashkia Sarandë dhe Blerësi, sipas VKB nr. 1, datë 07.07.1995.

28.1 Rekomandim: Titullari i njësisë publike, Bashkia Sarandë, të marrë masa për përfshirjen në listën e inventarit të pasurive të paluajtshme të njësisë vendore të truallit prej 400 m², parcela nr. 39, blloku H-2, zona A, kaluar në pronësi të njësisë vendore sipas Aktmarrëveshjes nr. 339, datë 16.02.2012, si dhe nisur nga pozicioni fizik i truallit të vlerësohet mundësia e dhënies me qira, ashtu sic rezulton të jetë vepruar edhe më parë, për sipërfaqen prej 200 m².

Menjëherë

29.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, nuk është kërkuar nga ALUIZNI Sarandë dhe ZVRPP Sarandë, parcelat dhe sipërfaqet e pronësisë të cilat pas finalizimit të procesit të legalizimit për subjektet përfituesve kanë rezultuar si sipërfaqe tej normës së lejuar për legalizim, pra jo objekt i trajtimit apo përfitimit nga ligji, duke u klasifikuar si pronë shtet, sipas ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 “Për pronat e paluajtshme të shtetit” dhe VKM nr. 500 datë 14.08.2001.

29.1 Rekomandim: Titullari i njësisë publike, Bashkia Sarandë, të kërkojë ALUIZNI Sarandë dhe ZVRPP Sarandë listën e trojeve të klasifikuara nga ALUIZNI si pasuri shtet dhe të regjistruara si të tilla në ZVRPP, duke u përfshirë në listën e inventarit të pronave të bashkisë.

Menjëherë dhe Vijimësi

30.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, nuk është hartuar një listë inventari e pasurive (aseteve) të njësisë vendore bazuar në gjendjen faktike të tyre, për rrjedhojë dhe lista e miratuar në këshillin bashkia dhe dërguar për miratim në Këshillin e Ministrave nuk përkon me gjendjen faktike të pasurive të bashkisë, pasi në hartimin e tyre është vepruar jo sipas ligjit nr. 8743, datë 22.02.2001 dhe VKM nr. 500 datë 14.08.2001.

30.1 Rekomandim: Titullari i njësisë publike, Bashkia Sarandë, bazuar dhe në sa trajtuar në raportin përfundimtar të auditimit, të ngre grup pune për hartimin dhe azhurnimin e listës përfundimtare të inventarit të pasurive (aseteve) të njësisë vendore bazuar në gjendjen faktike të tyre, duke proceduar më tej me propozimin për miratim dhe miratimin në Këshillin Bashkiak, Ministrinë e linjës e më tej të Këshillit të Ministrave, me qëllim kalimin në pronësi e përdorim.

Menjëherë dhe Vijimësi

31.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, nuk është ngritur një strukturë përgjegjëse për administrimin e aseteve të bashkisë, duke vepruar rast pas rasti, pa një kordinim ndërmjet strukturave të njësisë vendore, duke mos mundësuar krijimin e më shumë të ardhurave për buxhetin e bashkisë, si dhe një administrim më të mirë e profesional të resurseve të njësisë vendore.

31.1 Rekomandim: Titullari i njësisë publike, Bashkia Sarandë, të ngre strukturë dhe ta paraqesë për miratim në Këshillin Bashkiak, strukturë e cila duhet të kryejë periodikisht azhurnimin e të gjitha pasurive të paluajtshme të njësisë vendore, lidhjes së kontratave të qirasë, ndjekjes së zbatimit të tyre në bashkëpunim dhe me strukturat e tjera, si përsa i përket arkëtimit të detyrimit

ashtu edhe mirëmbajtjes së pasurisë, si dhe çdo problematikë tjetër që lidhet me inventarizimin dhe administrimin e tyre.

Menjëherë

32.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, për subjektet qiramarrëse të cilët nuk kanë paguar në kohë detyrimin e krijuar nga lidhja e kontratës së qirasë nuk janë aplikuar kamatëvonesa, nga 9 subjekte në shumën prej 916,780 lekë për vitin 2012 dhe dëmin ekonomik që rezulton nga mos aplikimi i kushtit penal prej 0.5% të vlerës mujore të qirasë për secilin, sipas nenit 7 “Sanksione” të secilës kontratë, për subjektet që ende nuk kanë përmbushur këtë detyrim, i cili është 65,178 lekë, dhe për 12 subjekte në shumën prej 1,256,816 lekë në vitin 2013 dhe dëmin ekonomik që rezulton nga aplikimi i kushtit penal prej 0.5% të vlerës mujore të qirasë për secilin subjekt që ende nuk kanë përmbushur këtë detyrim, i cili është 181,143 lekë.

32.1 Rekomandim: Titullari i njësisë publike, Bashkia Sarandë, të kërkojë nga strukturat përgjegjëse në bashki që për të gjithë subjektet qiramarrëse të cilët nuk kanë paguar në kohë detyrimin e krijuar nga lidhja e kontratës së qirasë të aplikohen kamatëvonesa, dhe të përlllogaritet dëmi ekonomik nga aplikimi i kushtit penal prej 0.5% të vlerës mujore të qirasë për secilin subjekt.

Menjëherë dhe Vijimësi

33.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, nuk janë ndjekur të gjitha proces gjyqësorë për shkeljet e konstatuara në fushën e ndërtimit të objekteve ndërtimore pa leje ndërtimi, madje në disa raste edhe pse ka filluar procesi gjyqësor rezulton se nga punonjësi e ngarkuar nuk është zbatuar kjo detyrë, duke mos qenë prezent në proces.

33.1 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria Juridike dhe INUV Bashkia Sarandë të ndiqen me përgjegjshmëri proceset gjyqësore për secilën gjobë të vendosur për ndërtime pa leje, për ato raste kur është konstatuar se nga subjektet është ushtruar e drejta e ankimit administrativ pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, si dhe të ndiqen në shkallët e tjera të gjyqësorit të gjitha ato praktika për të cilat gjykata ka vendosur ndryshe nga sa konstatuar nga njësia vendore.

Menjëherë dhe Vijimësi

34.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, në 13 rasteve në vlerën prej 1,026,409 lekë të pagesës me urdhërshpenzime për Prokurimeve me vlerë të vogël për punimet në infrastrukturë dhe ambientet publike, si rezultat i shpalljes fitues i personave fizik me preventiv ofertë pa TVSH dhe faturë të thjeshtë tatimore, ndërsa urdhrat e prokurimit janë me fond limit të përlllogaritur me TVSH, janë kryer veprime të cilat konsiderohen në shkelje të disiplinës financiare me pasojë mospërdorimin me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike të vëna në dispozicion.

34.1 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria Ekonomike të ngrihet një grup pune për saktësimin dhe përlllogaritjen e 13 rasteve në vlerën prej 1,026,409 lekë të pagesës me urdhërshpenzime për Prokurimeve me vlerë të vogël për punimet në infrastrukturë dhe ambientet publike, si dhe të merren të gjitha masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

35.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, në 5 rasteve në vlerën prej 986,943 lekë të pagesës me urdhërshpenzime të bëra nga artikulli 600 dhe 602 “Shpenzime operative”, për shpenzime pritje e përcjellje, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1999, “Për shpenzime pritje e përcjellje dhe trajtim që u bëhet delegacioneve të huaja”, janë kryer veprime të cilat

konsiderohen në shkelje të disiplinës financiare me pasojë mospërdorimin me efektivitet dhe ekonomikitet të fondeve publike të vëna në dispozicion.

35.1 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria Ekonomike të ngrihet një grup pune për saktësimin dhe përlogaritjen e 5 rasteve në vlerën prej 986,943 lekë të pagesës me urdhërshpenzime të bëra nga artikulli 600 dhe 602 “Shpenzime operative”, si dhe të merren të gjitha masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

36.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Tatim Taksave si pasojë e mosfunksionim të kësaj strukture dhe moszbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore janë konstatuar se në 13 rasteve në vlerën prej 2,292,950 lekë janë krijuar mungesë së të ardhurave të njësisë vendore dhe konkretisht:

Vlera prej **297,620 lekë**, nga Subjekti “K...F.” sh.a., për mos maturimin e kësaj shoqërie dhe heqja nga regjistri për vitin 2013, megjithëse ka statusin aktiv.

Vlera prej **38,920 lekë**, nga Subjekti “B...L...” Saranda, pasi proces verbali për verifikimin e aktivitetit datë 11.06.2013, ekstraktit nga QKR datë 19.4.2012 është pasiv.

Vlera prej **386,640 lekë**, nga subjekti “K...” Hotel, ku rezulton se në vitin 2012 është maturuar më pakë në shumën 244,740 lekë dhe për vitin 2013 është maturuar më pak në shumën 141,900 lekë.

Vlera prej **287,800 lekë** nga subjekti “K...J...”, ku për vitin 2012 maturuar me shkresën nr. 1059, datë 2012, në shumën 99,120 lekë, po kaq është kontabilizuar. Po në vitin 2012, ka dhe një vlerësimi tatimor me shkresën nr. 262 prot, datë 04.07.2012, për detyrimin në shumën 386,920 lekë, me një diferencë në shumën **287,800 lekë** më shumë se njoftimi i vlerësimit që ndodhej në dosje.

Vlera prej **39,600 lekë**, nga subjekti Hotel “K...”, për mos maturimi të saktë të sipërfaqeve të ndërtesës i është maturuar sipërfaqe më pak.

Vlera prej **720,000 lekë**, nga subjekti Hotel “S...”, pasi janë lëshuar dy njoftime detyrimi për vendosje shezlong me nr. 262 prot. datë 12.07.2012, në shumën 81,000 lekë dhe po me nr. 262 prot. datë 12.07.2012, në shumën 50,600 lekë, ndërsa në vitin 2013, nuk ka njoftim për detyrim, për vendosje shezlong, kurse në kontabilitet është maturuar për shezlong në shumën 56,000 lekë dhe jo për 81,000 lekë, me një diferencë 25,000 lekë, ndërsa për vitin 2011, me shkresën nr.ska datë 06.06.2011 është maturuar për shfrytëzim hapësire publike në vlerën 360,000 lekë

Vlera prej **200,200 lekë**, nga subjekti Hotel “P...F...”, për maturim jo të saktë, për taksën e ndërtesës në vlerën 112,500 lekë, është taksuar për vlerën 48,000 lekë, më pak në vlerën 64,500 lekë. Taksë fjetje duhej të matarohej për vlerën 46,800 lekë, është maturuar për vlerën 11,200 lekë, më pakë në vlerën 35,600 lekë duke shmangur detyrimi, për vitin 2012 dhe 2013.

Vlera prej **14,500 lekë**, nga subjekti Hotel “L...M...”, pasi ka ulur maturimin sipas Njoftimit të vlerësimit tatimor datë 04.07.2012, në shumën në shumën 14,500 lekë, pa asnjë dokument justifikues.

Vlera prej **48,670 lekë**, nga subjekti Hotel “M...K...” pasi Ekstrakti i QKR-së i datës 17.6.2012 ka status Aktiv dhe për vitin 2013, nuk është maturuar dhe pse statusi në QKR është po Aktiv.

Vlera prej **20,600 lekë**, nga subjekti Hotel “Alket Qendro”, pasi është ulur detyrimi pa asnjë dokument justifikues.

Vlera prej **20,200 lekë**, nga subjekti “H...Xh...”, pasi është mbyllur aktiviteti në datën 17.06.2012, kur rezulton me detyrim në shumën 20,200 lekë.

Vlera prej **103,220 lekë**, nga subjekti Hotel “A...B...”, pasi është mbyllur aktiviteti kur rezulton me një detyrim në shumën 103,220 lekë.

Vlera prej **115,740 lekë**, nga subjekti Hotel “R.V.”, pasi është mbyllur aktiviteti, pa asnjë dokument justifikues, kur rezulton me një detyrim në shumën 115,740 lekë, shmangur maturimi dhe për vitin 2013.

36.1 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Tatim Taksave të ngrihet një grup pune për saktësimin, përllogaritjen dhe vlerësimin tatimor për 13 rasteve në vlerën prej 2,292,950, si dhe të merren të gjitha masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit

Menjëherë

37.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Tatim Taksave si pasojë e mosfunksionim të kësaj strukture dhe moszbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore janë konstatuar përllogaritje të gabuar dhe vlerësim tatimor të 71 rasteve në vlerën prej 12,071,462 lekë, duke krijuar mungesë së të ardhurave të njësisë vendore pasi subjektet janë debitorë të mbartur nga viti 2012 dhe që aktualisht janë në punë por kanë detyrime ndaj bashkisë.

37.1 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Tatim Taksave të ngrihet një grup pune për saktësimin, përllogaritjen dhe vlerësimin tatimor të 71 rasteve në vlerën prej 12,071,462 lekë të krijimit të mungesës së të ardhurave të njësisë vendore, si dhe të merren të gjitha masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit.

Menjëherë

38.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Tatim Taksave si pasojë e mosfunksionim të kësaj strukture dhe moszbatimit të ligjit dhe akteve nënligjore janë konstatuar 9 subjekte në vitin 2012 për shumën prej 916,780 lekë dhe 12 subjekte në vitin 2013 për shumën prej 1,256,816 lekë të mos shlyerjes së detyrimit tatimor dhe mungesë së të ardhurave të njësisë vendore.

38.1 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria e Tatim Taksave, Drejtoria Ekonomike, Drejtoria Juridike si dhe çdo strukturë tjetër përgjegjëse, të veprohet e kërkohet arkëtimi i detyrimeve tatimore të papaguara nga 9 subjekte në vitin 2012 në shumën 916,780 lekë dhe 12 subjekte në vitin 2013 për shumën 1,256,816 lekë, si dhe të merren të gjitha masat dhe të kërkohet në rrugë ligjore arkëtimi i vlerës duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, si dhe të aplikohet prishja e kontratës për subjektet që refuzojnë shlyerjen e detyrimit.

Menjëherë

39.1 Gjetje nga auditimi: Nga Bashkia Sarandë, INUV dhe Drejtoria Juridike, si pasojë e mosfunksionim, mosrakoordimit dhe bashkëpunimit ndërmjet këtyre dy strukturave janë konstatuar 14 raste të ndërtimit të objekteve ndërtimore, përgjithësisht me karakter shërbimi, për të cilat nga bashkia nuk është proceduar me kallëzim penal, në kundërshtim me ligjin nr. 9780, datë 16.07.2007 “Për inspektimin e ndërtimit” dhe VKM nr. 862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor”.

39.1 Rekomandim: Nga Bashkia Sarandë, Drejtoria Juridike dhe INUV Bashkia Sarandë për 14 rastet e konstatimit të ndërtimit të objekteve ndërtimore pa leje nga Bashkia Sarandë,

përgjithësisht me karakter shërbimi, për secilin rast të veprohet me zbatimin e ligjit duke paraqitur kallëzim penal në prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë,

Menjëherë

B. MASA PËR SHPËRBLIM DËMI

Nga Bashkia Sarandë të merren masat duke kontabilizuar dhe kërkuar në rrugë ligjore arkëtimin e vlerës prej **24,337,293 lekë** duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe procedurat e tjera në të gjitha shkallët e gjykimit, dhe konkretisht:

I. Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore për 11 procedura zbatimi kontratash investimi në vlerën prej **5,947,706 lekë** si pasojë e pagesave të paligjshme dhe të pamerituara, të përfituar nga përllogaritja dhe likuidimi i punimeve të situacionuara por të pa realizuara në fakt, por rritje fiktive të fondit të projektit dhe në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” pikat 2, 3, 9, 10 dhe 12, në kundërshtim me VKM nr. 514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit”.

1. Vlera **1,927,328** lekë bashkimit të OE “D...” sh.p.k dhe H...” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Rikonstruksion dhe kthim në identitet të terreneve sportive të Stadiumit të lojërave me dorë”, për punime të pakryera.
2. Vlera **1,393,495** lekë OE “M.../s” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Restaurim e rritje e performancës së lulishtes Hasan Tahsini”, nga të cilat vlera 192,974 për punime të pakryera dhe vlera 1,200,521 lekë të përfituara.
3. Vlera **1,127,750** lekë OE “N...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Rikonstruksioni i varrezave të dëshmorëve”, për punime të pakryera.
4. Vlera **774,664** lekë OE “N...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Përmirësimi i rrjetit të Furnizimit me ujë për komunitetin, emergjenca”, për punime të pakryera.
5. Vlera **143,820** lekë OE “F... K...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Rikonstruksion rrugësh, shtrim, ndriçim në pjesën e sipërme të qytetit, Lagja 3”, për punime të pakryera.
6. Vlera **130,755** lekë OE “G...” sh.p.k, në cilësinë e sipërmarrësit në tenderin me objekt “Rikonstruksion, shtrim rruge blloku i banimit Limion, Lagja 3”, për punime të pakryera.
7. Vlera **111,651** lekë Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve, P.H. në cilësinë e hartuesit të projekt-preventivit për objektin “Restaurimi dhe ndërtimi i ambienteve në funksion të Zadrës së notit, faza II”, e cila përfaqëson rritje fiktive të fondit limit për realizimin e objektit.
8. Vlera **305,710** lekë ish-Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve, A.T. në cilësinë e hartuesit të projekt-preventivit për objektin “Rikonstruksion dhe kthim në identitet të terreneve sportive të Stadiumit të lojërave me dorë”, e cila përfaqëson rritje fiktive të fondit limit për realizimin e objektit.
9. Vlera **32,533** lekë ish-Drejtorit të Drejtorisë së Shërbimeve, A.T. në cilësinë e hartuesit të projekt-preventivit për objektin “Rikonstruksion e riveshje rruga hyrëse dhe rruga Onhezmi - kryqëzimi kryesor”, e cila përfaqëson rritje fiktive të fondit limit për realizimin e objektit.

Menjëherë

II. Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore për 3 procedura përlllogaritje taksash dhe tarifash vendore në vlerën prej **11,949,960 lekë** si pasojë e mos përlllogaritjes të sipërfaqeve të reklamave sipas kontratave dhe sipërfaqes faktike, në kundërshtim me nenin 21, 32 dhe 32/1 të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, me ndryshime si më poshtë:

1. Shuma prej **9,783,960 lekë**, dëm ekonomik i shkaktuar nga shoqëria “A...” sh.p.k, ka përfituar për mos kryerjen e pagesave të sipërfaqeve të reklamave të vendosura mbi sipërfaqet e përcaktuara në kontratë për tre vitet 2012, 2013 dhe 2014, në kundërshtim me nenin 1 dhe 11 të kontratës datë 26.03.2013 dhe me VKB nr. 43, datë 22.12.2011”Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2012.

2. Shuma prej **729,000 lekë**, dëm ekonomik i shkaktuar nga shoqëria “F...” Kompani, ka përfituar për mos kryerjen e pagesave të sipërfaqeve të reklamave të vendosura mbi sipërfaqet e përcaktuara në kontratë për dy vitet 2012, 2013, në kundërshtim me nenin 1 të Kontratës nr. 95, datë 03.01.2012.

3. Shuma prej **582,000 lekë**, dëm ekonomik i shkaktuar nga T...M... dhe E...Gj..., për lidhjen e dy kontratave për zënien e hapësirave publike për vendosjen e tabelave me shoqërinë “A...” sh.p.k., për të njëjtat sipërfaqe por me vlera të ndryshme të kontratave nr. *ska* datë 26.03.2012, nr. 26.03.2013 dhe 11.03.2014, në kundërshtim me nenin 1 dhe 11 të kontratës datë 26.03.2013 dhe me VKB nr. 43, datë 22.12.2011”Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2012.

Menjëherë

III. Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore për 6 procedura dhënie pagash në vlerën prej **904,152 lekë**, si pasojë e përlllogaritjes sa gabuar dhe pagesës të punonjësve me arsim të lartë, diplomuar me diplomë Bachelor apo (DNP) me diplomë të nivelit të parë, në kundërshtim me kërkesat e lidhjes nr. 2, “Niveli i pagave për nënpunësit civil në bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe nënpunësit e komunave”, lidhja nr. 6 “Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar” të VKM nr.586, datë 17.07.2013, si dhe të VKM nr. 553, datë 11.08.2011, VKM nr. 518, datë 16.08.2012 dhe VKM nr. 586, datë 17.07.2013, si më poshtë:

1. S.D. me detyrë Specialiste në Drejtorinë Ekonomike, paguar më tepër në vlerën prej 128,466 lekë.

2. N.A. me detyrë Specialiste Kontrolli në Drejtorinë e të Ardhurave paguar më tepër në vlerën prej 61,782 lekë.

3. E.Dh. me detyrë Specialist i Hetimit Tatimor në Drejtorinë e të Ardhurave, paguar më tepër në vlerën prej 226,187 lekë.

4. E.C. me detyrë Specialist në Drejtorinë e Urbanistikës, paguar më tepër në vlerën prej 164,661 lekë.

5. A.K.me detyrë Inspektor në Inspektoriatin e ndërtimit nga data 23.06.2010 deri më 30.04.2014, paguar më tepër në vlerën prej 163,241 lekë.

6. T.H. me detyrë Specialist në Drejtorinë e Urbanistikës, paguar më tepër në vlerën prej 159,815 lekë.

Menjëherë

V. Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore për 23 procedura të dhënies me qira të aseteve në vlerën prej **3,171,921 lekë**, si pasojë e mos administrimit të rregullt të aseteve të dhëna me qira, në kundërshtim me VKM nr. ë, datë 08.6.2011 *“Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”*, aktualisht e ndryshuar me VKM nr. 54, datë 5.2.2014, si më poshtë:

1. Shuma prej 2,700,000 lekë, për 3 vite, për Kontratën nr. *ska*, datë 01.05.2011, *“Për dhënien me qira të objektit Pontili i ri”*, me palë qiramarrëse B.B. dhe objekt kontrate sipërfaqen prej 1400 m² truall i lirë me qëllim përdorimi *“Lokal Shërbimi”*, ku është konstatuar se sipas planimetrisë së sheshit të dhënë me qira, të hartuar nga bashkia, sipërfaqja që përdor subjekti qiramarrës me sipërfaqen që ai realisht disponon është më e madhe, pasi nuk janë përfshirë 2 parcela në të cilat ky subjekt ofron shërbimin, të cilat rezultojnë të jenë mbi 500 m², nga ku mbi gjysma rezulton sipërfaqe e ndërtuar, duke sjellë për pasojë dëm ekonomik në vlerën prej 900,000 lekë për vit.
2. Shuma prej 225,600 lekë, për Kontratën nr. *ska*, datë 15.03.2012, *“Për dhënien me qira të objektit Lokal Riviera”*, me palë qiramarrëse A.G., etj, dhe objekt kontrate me qëllim përdorimi *“Bar”*, shkaktuar nga aplikimi i gabuar i tarifës dhe vlerës dysheme, ku është përcaktuar se çmimi është jo më pak se 150 lekë/m² në muaj”, ndërsa bashkia e ka lidhur atë me 100 lekë m² në muaj, pra më pak me 50 lekë/m² në muaj.
3. Shuma prej 181,143 lekë, për vitin 2013 nga 12 subjekte qiramarrëse si rezultat i mos aplikimit të kushtit penal prej 0.5% të vlerës mujore të qirasë, sipas nenit 7 *“Sanksione”* të secilës kontratë, për subjektet që ende nuk kanë përmbushur në kohë këtë detyrim.
4. Shuma prej 65,178 lekë, për vitin 2012 nga 9 subjekte qiramarrëse si rezultat i mos aplikimit të kushtit penal prej 0.5% të vlerës mujore të qirasë, sipas nenit 7 *“Sanksione”* të secilës kontratë, për subjektet që ende nuk kanë përmbushur në kohë këtë detyrim.

Menjëherë

VI. Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore për 5 procedura të marrjes në punë të punonjësve në vlerën prej **216,938 lekë**, si pasojë e marrjes në punë mbi numrin e miratuar në këshillin bashkiak si dhe për pagesë rroge mujore pa qenë prezent në detyrë, veprimeve në kundërshtim me kërkesën e nenit 69, të UMF nr.30, datë 27.12.2011 dhe VKB nr.75, datë 20.01.2014, si më poshtë:

1. Për arkëtimin e shumës prej 173,600 lekë neto, pasi në strukturën organike dhe numrin e punonjësve të Bashkisë, të miratuar me, janë planifikuar 82 punonjës, por rezulton se për muajin Shkurt janë mbajtur në punë e paguar 86 punonjës, pra paguar 4 punonjës mbi numrin e miratuar.
2. Për arkëtimin e shumës prej 43,338 lekë, pasi listprezencat e muajit Janar e Shkurt të vitit 2014, janë firmosur vetëm nga Kryetari i Bashkisë, ku në listprezencat e muajit Shkurt, figuron edhe emri i punonjës E.B., pra ka mospërputhje të listës të paraqitur nga Drejtoria Ekonomike në Drejtorinë e Personelit me atë të firmosur nga Kryetari, pra paguar pa qenë në detyrë.

VII. Lidhur me dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore në 3 procedura lidhur me marrjen në dorëzim të mallrave dhe kryerjen e shërbimeve, në vlerën prej **2,146,616 lekë**, si më poshtë:

1. Nga subjekti juridik privat *“I...” sh.p.k.* në vlerën prej **278,665 lekë**, për prokurimin *“Blerje nafte për nevojat e bashkisë Sarandë dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve”* për vitet 2012-2013, pasi në çmimin e kontratës është përfshirë edhe norma e fitimit 10 lekë për litër, vlerë e cila është në kundërshtim me vet ofertën e operatorit ekonomik fitues në të cilën nuk është përcaktuar norma e fitimit.

2. Nga operatori ekonomik subjekt fizik *“E.D.”*, në vlerën prej **288,000 lekë**, për prokurimin *“Blerje automjet vetëshkarkues me kapacitet 2-3 ton për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike”*, pasi është bërë likuidimi me TVSH, në kundërshtim me ligjin me neni 1, pika 2/a nr. 7928 datë 27.4.1995 *“Për tatimin mbi vlerën e shtuar”*, i ndryshuar, pasi subjekti nuk është person i tatueshëm, duke i paguar padrejtësisht vlerën 288,000 lekë, si diferencën ndërmjet vlerës 1,440,000 leke pa TVSh dhe vlerës 1,728,000 lekë me tvsh.

3. Nga subjekti juridik privat *“K...” sh.p.k.* në vlerën prej **190,960 lekë**, për prokurimin *“Pastrimin e bashkisë Sarandë me afat 73 ditë”*, pasi:

c. Zëri *“Heqja e mbetjeve inerte nga mjediset publike”* përkatësisht në vlerat **190,960 lekë, 80,301 lekë dhe 80,297 lekë** në preventivat e shërbimeve janë parashikuar në kundërshtim me kreun II, neni 5 të ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 *“Për largimin publik të mbeturinave”*, duke sjellë përfitim të padrejtë e të pamërituar nga operatori ekonomik, pasi këto shuma janë të paargumentuara dhe padokumentuara.

C. MASA DISIPLINORE

C.I. Mbështetur në nenin 58 *“Llojet e masave disiplinore”* dhe nenin 59 *“Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore”* të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 *“Për nëpunësin civil”* dhe VKM nr. 171, datë 26.3.2014 *“Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil”*, Kryetari i Bashkisë Sarandë, për shkelje të rëndë të ligjit të kërkojë fillimin e procedurës për dhënien e masës disiplinore *“largim nga shërbimi civil”* parashikuar nga neni 58 pika “ç” e ligjit nr. 152/2013, për punonjësit si më poshtë:

T.M. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Taksave dhe Tarifave vendore, pasi:

Për mosrealizim të ardhurave nga rekomandimet e KLSH-së, për hoteleri në vlerën 1,807,273 lekë, dhënien me qira të truallit në vlerën 219,814 lekë nga 5 persona.

Për të metat dhe dobësitë e konstatuara në Drejtorinë e Taksave dhe të Ardhurave Vendore në lidhje me evidentimin dhe ndjekjen e debitorëve në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme *“Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë”*, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë, nr. 88 datë 17.07.2008, neni 4, Detyrat e Drejtorisë së të ardhurave lokale, neni 5, Detyrat e Drejtorit të Drejtorisë së të ardhurave lokale, si dhe nenin 1 dhe 11 të kontratës datë 26.03.2013, me VKB nr. 43, datë 22.12.2011 *“Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2012 dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me ndryshime dhe konkretisht:*

Për dëmin ekonomik shkaktuar buxhetit të shtetit dhe njësisë së qeverisjes vendore për 3 procedura përlllogaritje taksash dhe tarifash vendore në vlerën prej **11,949,960 lekë** si pasojë e

mos përlllogaritjes të sipërfaqeve të reklamave sipas kontratave dhe sipërfaqes faktike, në kundërshtim me nenin 21, 32 dhe 32/1 të ligjit 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, nga ku:

Shuma prej **9,783,960 lekë**, dëm ekonomik i shkaktuar nga shoqëria “A...” sh.p.k, ka përfituar për mos kryerjen e pagesave të sipërfaqeve të reklamave të vendosura mbi sipërfaqet e përcaktuara në kontratë për tre vitet 2012, 2013 dhe 2014, dhe për moskontrollin e sipërfaqes dhe numrit të reklamave sipas kontratës, në kundërshtim me nenin 1 dhe 11 të kontratës datë 26.03.2013 dhe me VKB nr. 43, datë 22.12.2011”Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2012”.

Shuma prej **729,000 lekë**, dëm ekonomik i shkaktuar nga shoqëria “F...” Kompani, ka përfituar për mos kryerjen e pagesave të sipërfaqeve të reklamave të vendosura mbi sipërfaqet e përcaktuara në kontratë për dy vitet 2012, 2013, në kundërshtim me nenin 1 të Kontratës nr. 95, datë 03.01.2012

Shuma prej **582,000 lekë**, dëm ekonomik i shkaktuar, për lidhjen e dy kontratave për zënien e hapësirave publike për vendosjen e tabelave me shoqërinë “A...” sh.p.k., për të njëjtat sipërfaqe por me vlera të ndryshme të kontratave nr. *ska* datë 26.03.2012, nr. 26.03.2013 dhe 11.03.2014, në kundërshtim me nenin 1 dhe 11 të kontratës datë 26.03.2013 dhe me VKB nr. 43, datë 22.12.2011”Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2012.

Për mos kontrollimin e vendosjes të reklamave në territorin e Bashkisë Sarandë, duke favorizuar shoqërinë “A...” sh.p.k, që të vendosë reklama sipas dëshirës në çdo kohë dhe në çdo vend, pasi vendndodhja e tyre nuk përcaktohet në kontratë, edhe pse nga inventarizimi që ka kryer gjatë vitit 2012 dhe 2013, ka konstatuar një tejkalim të dukshëm të sipërfaqeve të reklamave, duke mos mbajtur sanksione dhe duke lejuar përfitime të padrejta e pamerituara.

Për mosmarrjen e masave lidhur me vjeljen e detyrimeve tatimore nga 2093 subjekte në shumën 79,311,473 lekë, nga ku për 1202 subjekte fizike e juridike në vlerën 75,707,033 lekë, për 77 subjekte tregu në vlerën 558,203 lekë, për 814 subjekte të tokës bujqësore në vlerën 3,046, 237 lekë. Nuk ka mundur që debitorët e vitit 2012, që janë 1701 subjekte në vlerën 55,651,358 lekë, ti detyrojë që të paguajnë detyrimin gjatë vitit 2013, por sipas listave të debitorëve të vitit 2013 rezulton se janë 2093 subjekte në total në vlerën 79,311,473 lekë, duke sjellë për pasojë rritjen e debitorëve në 392 raste në vlerën 23,660,115 lekë dhe jo pakësimin e tyre.

Për mosmarrjen e masave lidhur me regjistrimin në QKR, të 622 subjekte të cilat rezultojnë të pa regjistruar dhe që vazhdojnë rregullisht aktivitetin e tyre, dhe për mosvendosjen e gjobave, në zbatim të nenit 112 të ligjit 9920, datë 19.05.2008 , “Për procedurat tatimore”.

Për mosmarrjen e masave lidhur me aplikimin e vendosjes së barrës siguroese, në Drejtorinë Rajonale të Transportit Sarandë (për mjetet) dhe për moskërkimin e vendosjes së *gjobave në masën 5-25% të detyrimit sipas nenit 114, të ligjit nr. 9920 datë 19.05.2008” Për Procedurat tatimore*”, për rastet kur tatim paguesi nuk paguan në datën e caktuar detyrimin tatimor, në përputhje me nenin 89 të ligjit.

Në fund të vitit 2013, janë konstatuar 1202 subjekte fizike e juridike debitor me vlerën 75,707,033 lekë. Subjekte tregu 77 në vlerën 558,203 lekë dhe Subjekte të tokës bujqësore 814, në vlerën 3,046,237 lekë.

Në listën e debitorëve të vitit 2012 dhe 2013, rezulton që nuk janë vendosur gjoba në masën deri në 25 përqind, për detyrimin e pa arkëtuar në afatin ligjor.

Janë nxjerrë listat për subjektet debitorë për pagesën e detyrimeve, por nuk i janë dërguar zyrtarisht Policisë Bashkiake dhe Zyrës së Financës, nuk është raportuar e nuk i është kërkuar

Këshillit Bashkiak Sarandë ndërhyrje me forcë e Policisë Bashkiake, për vjeljen e subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, germa “ç” nënpika “iii”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

Për subjektet debitorë nuk i është kërkuar, *Drejtorisë Rajonale të Transportit, vendosja e bares siguruese (për mjetet)*, duke shkelur ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” dhe konkretisht në nenin 91.

Për arkëtimin e këtyre detyrimeve janë mjaftuar vetëm me dërgimin e shkresave në subjekt pa ndërmarrë veprime të tjera ligjore si ndërhyrje me forcë të mbylljes të aktivitetit, vendosjen gjobave, sekuestrimin e mallit dhe denoncimin në prokurori, duke sjellë për pasojë rritjen e detyrimeve fiskale nga viti në vit, po ashtu edhe maturimet.

Për dosjet e subjekteve të hotelerisë janë konstatuar praktika ku Dosje që s’kanë asnjë dokumentacion, me përjashtim të njoftimeve të vlershmit të detyrimit janë 54, dosje që kanë vërtetimin e Hipotekës 16, dosje që kanë vetëm Gent Planet 14, dosje që kanë vetëm Procesverbale 10; tregues se se vendosja e maturimit për sipërfaqet e ndërtesave, sipërfaqet e zënies të hapësirave publike, nr. e dhomave, është përcaktuar në mënyrë fiktive.

Nuk është ngritur një grup pune me mbështetje të policisë bashkiake për të verifikuar në çdo subjekt sipërfaqet e zaptuar në hapësirat publike e në veçanti plazhet, në referim të VKM nr. 358, datë 01.06.2012, “Për sigurinë”.

Në dosjet e subjekteve të hotelerisë në asnjë rast nuk u gjenden kërkesat e subjekteve për ndryshim të maturimit, si dhe nuk u gjenden, Njoftimet e Vlerësimit tatimor të bëra nga vet zyra

Numri i hoteleve të regjistruar me atë faktik është jo real, pasi në bashkinë Sarandë për vitin 2011, janë të regjistruar 103 subjekte hotelerie, nga këta janë debitor 74 subjekte, në vlerën 9,299,727 lekë, për vitin 2012, janë të regjistruar 94 subjekte hotelerie, nga ku debitor 69 subjekte në vlerën 14,342,723 lekë, dhe për vitin 2013, janë të regjistruar 96 subjekte hotelerie, nga këta janë debitor në vlerën 19,771,780 lekë, si dhe për 18 subjekte hotelerie që vazhdojnë aktivitetin e tyre rregullisht kanë një detyrim 12,071,462 lekë.

Lidhur me dhënien me qira të aseteve të bashkisë nga ku ka rezultuar se për vitin 2012 nga 29 nga të cilat 21 kontrata të lidhura rishtazi dhe 8 të trashëguara në vlerën prej 4,929,980 lekë nuk janë paguar vlera e plotë e qirasë nga 9 subjekte në shumën prej 916,780 lekë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë, pa llogaritur dëmin ekonomik nga aplikimi i kushtit penal prej 0.5% të vlerës mujore të qirasë për secilin subjekt, sipas nenit 7 “Sanksione” të secilës kontratë, për subjektet që ende nuk kanë përmbushur këtë detyrim, i cili është 65,178 lekë.

Lidhur me dhënien me qira të aseteve të bashkisë nga ku ka rezultuar se për vitin 2013 nga 29 kontrata nga të cilat 17 kontrata të lidhura rishtazi dhe 12 të trashëguara në vlerën prej 4,737,366 lekë nuk janë paguar vlera e plotë e qirasë nga 12 subjekte në shumën prej 1,256,816 lekë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë, pa llogaritur dëmin ekonomik nga aplikimi i kushtit penal prej 0.5% të vlerës mujore të qirasë për secilin subjekt, sipas nenit 7 “Sanksione” të secilës kontratë, për subjektet që ende nuk kanë përmbushur këtë detyrim, i cili është 181,143 lekë.

Lidhur me hartimin dhe zbatimin e Kontratës nr. ska, datë 15.03.2012, “Për dhënien me qira të objektit Lokal Riviera”, dhe objekt kontrate e qëllim përdorimi “Bar”, me çmim prej 18,800 lekë në muaj për objektin ose 225,600 sipërfaqen prej 188 m² “ndërtesë” dhe 150 m² verandë lekë në vit dhe për verandën 100 lekë për m²/muaj për 4 muaj dhe 15,000 lekë ose 60,000 lekë për 4 muaj, lidhur kontrata për 10 vite, nga ku është konstatuar një dëm ekonomik prej 225,600 lekë nga moszbatimi i VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe

të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Kreu III, “Tarifat dhe Vlera DysHEME për Pasuritë Shtetërore që Jepen me Qira ose Enfiteozë”, ku është përcaktuar se vlera mujore e qirasë për ndërtesat është 150 lekë/m² në muaj, kurse nga bashkia kjo vlerë është vendosur në 100 lekë/m² në muaj.

Lidhur me zbatimin e Kontratës nr. ska, datë 01.05.2011, “Për dhënien me qira të objektit Pontili i ri”, dhe objekt kontrate sipërfaqen prej 1400 m² truall i lirë dhe qëllim përdorimi “Lokal Shërbimi”, me çmim prej 140,000 lekë, lidhur kontrata për 20 vite, ku është konstatuar se sipërfaqja që përdor subjekti qiramarrës me sipërfaqen që ai realisht disponon është shumë e madhe, pasi nuk janë përfshirë 2 parcela në të cilat ky subjekt ofron shërbimin, të cilat përafërsisht rezultojnë të jenë mbi 500 m², nga ku mbi gjysma rezulton sipërfaqe e ndërtuar. Mosllogaritja e kësaj sipërfaqe përbën jo vetëm moszbatim të VKM nr. 529, datë 08.6.2011, por dhe një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Sarandë e cila llogaritet përafërsisht në afro 900,000 lekë në vit ose 2,700,000 për tri vite.

C.II. Mbështetur në nenin 154, të ligjit nr. 7961, datë 12.07.1996 “Kodi i Punës”, i ndryshuar, kontratave individuale të punës, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Sarandë, që bazuar në nenin 44, të ligjit nr. 8652 datë 31/07/2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, të fillojë procedurat për dhënien e masave disiplinore **“Vërejtje me shkrim”**, për punonjësit, si më poshtë:

J.M. me detyrë NënKryetar i Bashkisë, në cilësinë e punonjësit të ngarkuar me administrimin e aseteve të njësive vendore, pasi:

Për mos zbatim të VKB nr. 72, datë 23.10.2012 “Për miratimin e rregullores model të planifikimit për qytetin e Sarandës dhe Hartave që shoqërojnë këtë rregullore”, pika 7 “Të kërkojë pranë strukturave përkatëse shtetërore miratimin e listës përfundimtare të pronave që i transferohen Bashkisë Sarandë, miratuar me VKB nr. 10, datë 08.4.2011 “Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme shtetërore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Sarandë”.

Lidhur me dhënien me qira të aseteve të bashkisë nga ku ka rezultuar se për vitin 2012 nga 29 nga të cilat 21 kontrata të lidhura rishtazi dhe 8 të trashëguara në vlerën prej 4,929,980 lekë nuk janë paguar vlera e plotë e qirasë nga 9 subjekte në shumën prej 916,780 lekë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë, pa llogaritur dëmin ekonomik nga aplikimi i kushtit penal prej 0.5% të vlerës mujore të qirasë për secilin subjekt, sipas nenit 7 “Sanksione” të secilës kontratë, për subjektet që ende nuk kanë përmbushur këtë detyrim, i cili është 65,178 lekë.

Lidhur me dhënien me qira të aseteve të bashkisë nga ku ka rezultuar se për vitin 2013 nga 29 kontrata nga të cilat 17 kontrata të lidhura rishtazi dhe 12 të trashëguara në vlerën prej 4,737,366 lekë nuk janë paguar vlera e plotë e qirasë nga 12 subjekte në shumën prej 1,256,816 lekë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë, pa llogaritur dëmin ekonomik nga aplikimi i kushtit penal prej 0.5% të vlerës mujore të qirasë për secilin subjekt, sipas nenit 7 “Sanksione” të secilës kontratë, për subjektet që ende nuk kanë përmbushur këtë detyrim, i cili është 181,143 lekë.

Lidhur me hartimin dhe zbatimin e Kontratës nr. ska, datë 15.03.2012, “Për dhënien me qira të objektit Lokal Riviera”, dhe objekt kontrate e qëllim përdorimi “Bar”, me çmim prej 18,800 lekë në muaj për objektin ose 225,600 sipërfaqen prej 188 m² “ndërtesë” dhe 150 m² verandë lekë në

vit dhe për verandën 100 lekë për m²/muaj për 4 muaj dhe 15,000 lekë ose 60,000 lekë për 4 muaj, lidhur kontrata për 10 vite, nga ku është konstatuar një dëm ekonomik prej 225,600 lekë nga moszbatimi i VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Kreu III, “Tarifat dhe Vlera DysHEME për Pasuritë Shtetërore që Jepen me Qira ose Enfiteozë”, ku është përcaktuar se vlera mujore e qirasë për ndërtesat është 150 lekë/m² në muaj, kurse nga bashkia kjo vlerë është vendosur në 100 lekë/m² në muaj.

Lidhur me zbatimin e Kontratës nr. ska, datë 01.05.2011, “Për dhënien me qira të objektit Pontili i ri dhe objekt kontrate sipërfaqen prej 1400 m² truall i lirë dhe qëllim përdorimi “Lokal Shërbimi”, me çmim prej 140,000 lekë, lidhur kontrata për 20 vite, ku është konstatuar se sipërfaqja që përdor subjekti qiramarrës me sipërfaqen që ai realisht disponon është shumë e madhe, pasi nuk janë përfshirë 2 parcela në të cilat ky subjekt ofron shërbimin, të cilat përafërsisht rezultojnë të jenë mbi 500 m², nga ku mbi gjysma rezulton sipërfaqe e ndërtuar. Mosllogaritja e kësaj sipërfaqe përbën jo vetëm moszbatim të VKM nr. 529, datë 08.6.2011, por dhe një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Sarandë e cila llogaritet përafërsisht në afro 900,000 lekë në vit ose 2,700,000 për tri vite.

Për moszbatim të VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Kreut VII “Shpërndarja e të Ardhurave”, pika 1 ku përcaktohet se: “Të ardhurat, që krijohen nga lidhja e kontratave, ku METE ushtron të drejtën e përfaqësuesit të pronarit të pronës shtetërore, ndahen, si më poshtë vijon: 70 për qind, buxheti i shtetit; 30 për qind, ndërmarrja, shoqëria apo institucioni shtetëror, që ka në administrim objektin e dhënë me qira”, pasi objektet e dhëna me qira nuk rezultojnë në pronësi të Bashkisë Sarandë por në administrim të saj për sa kohë nuk është miratuar nga KM lista përfundimtare e pronave të paluajtshme.

Pronat e dhëna me qira nuk figurojnë të regjistruar në ZVRPP, si dhe nuk evidentohet se me çfarë VKM-je dhe kujt numri rendor apo pasuror i korrespondon kalimi në pronësi apo përdorim të Bashkisë, veprim është në kundërshtim me kreun IV nenin 13, neni 18 ligjin nr. 8744, datë 22.2.2001, dhe me pikat 1, 2 të nenit 45 të ligjit nr. 33/2012 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, si dhe në kundërshtim me nenin 678 të Kodit Civil.

Nuk është zbatuar VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, pika 2/ç sipas të cilës: “Dërgojnë në degën e shoqërive publike pranë prefekturës një kopje të kontratave të lidhura sipas shkronjave “a” dhe “b”, të pikës 6 të kapitullit I të këtij vendimi, **shoqëruar me kopje të genplanit të objektit të dhënë me qira**”, pasi në asnjë kontratë të vënë në dispozicion nuk rezultoi të jetë hartuar genplani i objektit të dhënë me qira, sipërfaqes funksionale e truallit të lirë.

Nuk janë zbatuar përcaktimet e ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, neni 15,17, 18, 29, 30, 33 dhe nenit 34, pasi shkelja e këtyre dispozitave ka mundësuar mos ndjekjen e procedurave të konkurrimit, mos mbajtjen e akteve të kontrollit, mos përcaktimin në kontratë të kontureve të sipërfaqes, si dhe mos evidentimit të përdorimit apo jo të së njëjtës sipërfaqe të dhënë me qira apo përdorimit edhe të sipërfaqeve të tjera.

Nuk është zbatuar as UKM nr. 1, datë 02.7.2012 “Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor e kullosor publik”.

Për të gjitha kontratat konstatohet se nuk ka ekstrakt nga QKR për objektin e veprimtarisë, si dhe dokument identifikimi të kërkuarit apo kërkuarve.

Kontratat nuk figurojnë të jenë protokolluar në zyrën e protokollit të institucionit, pasi asnjëra prej tyre nuk ka numër protokollit por vetëm datën dhe vulën e institucionit.

Për çdo kontratë nuk administrohet asnjë dokument shkresor, lidhur me miratimin nga këshilli i bashkisë të dhënies së sipërfaqes me qira dhe konfirmimi i aktit nga Prefekti.

Pronat nuk figurojnë të regjistruar në ZVRPP Sarandë, si dhe nuk evidentohet se sipas VKM-së, me çfarë numri rendor apo pasuror i korrespondon kalimi i saj në pronësi apo përdorim Bashkisë Sarandë.

Në asnjë rast nuk ka një genplan të pasurisë së dhënë me qira apo dhe kur ekziston një skicë ajo është fotokopje dhe e pa elementët teknikë identifikues, si dhe nuk është e miratuar nga titullari i bashkisë apo strukturat e tjera të ngarkuara prej tij, edhe pse në cdo kontratë citohet sipas hartës bashkëlidhur kësaj kontrate.

Për mos zbatim nga Bashkia Sarandë të VKM nr. 280, datë 15.01.1996 “Për ruajtjen, mirëmbajtjen dhe dhënien me qira të objekteve fortifikuese e mbrojtëse”, të ndryshuar me VKM nr. 1001, datë 13.11.2013, si dhe nr. 529, datë 08.6.2011 e më parë VKM nr. 1712, datë 24.12.2008, ka sjellë të ardhura të munguara për Bashkinë Sarandë ku nga 81 vendstrehime me sipërfaqe totale prej 23,690 m² 20% e sipërfaqe është thuajse baraz me 4738 m² x 75 lekë/m² x 12 muaj = 4,264,200 lekë vetëm për vitin 2012 dhe po kjo vlerë për vitin 2013, pra në total të ardhurat e munguara për të dy vitet së bashku janë 8,528,400 lekë. Për sa i përket 5% të vendstrehime që aktualisht përdoren nga privatë, pa kontrata qiraje, pra në mënyrë të jashtëligjshme 5% e sipërfaqe është thuajse afro 1184 m² x 75 lekë/m² x 12 muaj = 1,065,600 lekë vetëm për vitin 2012 dhe po kjo vlerë për vitin 2013. Në total të ardhurat e munguara për të dy vitet së bashku janë 2,131,200 lekë.

Pasi bazuar në informacionin nr. 38, datë 27.6.2014, rezulton se afro 30% e vendstrehime nuk ekzistojnë më edhe pse janë të përfshira në totalin prej 81 vendstrehimeve të cilat janë kërkuar të kalojnë në pronësi të njësisë vendore, tregues se lista i inventarit të pasurive të paluajtshme të miratuara nga këshilli bashkia dhe që janë në pritje për miratim nga KM, nuk është aspak real, dhe nuk është bërë mbi bazën e verifikimeve në terren, duke dëshmuar se nga strukturat përgjegjëse nuk është vlerësuar sa duhet ky proces.

F.V. me detyrë K/Inspektor i Policisë Bashkiake

K.B. me detyrë Inspektor i policisë Bashkiake, pasi:

Për vitin 2012 dhe 2013, nga ana e policisë Bashkiake nuk është mbajtur asnjë akt konstatimi apo procesverbal për zgjidhjen apo mos zgjidhjen e këtyre ankesave, apo ndëshkim me masë administrative (gjobë), si dhe nuk ka asnjë informacion me shkrim për zgjidhjen e këtyre ankesave.

Për mosarkëtim të gjobave të vendosura lidhur me shkeljen e rregullave të qarkullimit rrugor ku janë ndëshkuar me masë administrative (gjoba) 143 subjekte në vlerën 225,000 lekë, por janë arkëtuar 12 gjoba, në vlerën 28,000 lekë, duke mos u arkëtuar 11 gjoba, në vlerën 32,500 lekë.

Mos vjelja e gjobave është në kundërshtim me ligjin nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, neni 14 pika 2 dhe ligjin nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, nenet, 9, 22 dhe 30.

Nuk janë kryer rakordime për detyrimet e gjobave të pa vjela, nuk janë drejtuar organeve të drejtësisë për vjeljen e detyrimeve sipas kërkesave të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”, si dhe nuk janë kryer rakordime për fletët e gjobave të furnizuara,

arkëtimet dhe gjobat e paprera.

Policia bashkiake nuk ka propozuar dhe miratuar në këshillin bashkiak paketën me llojet dhe masën e gjobës për çdo shkelje të cilat përbëjnë kundërvajtje administrative, në kundërshtim me nenin 6 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative”.

Nuk ka praktikë tjetër se çfarë është bërë me shkelësit e ligjit, ku rezulton se për vitin 2012 dhe 2013, Bashkia Sarandë nuk ka arkëtuar nga të ardhurat e planifikuara shumën 131,962,831 lekë si më poshtë:

Për vitin 2012, nuk kanë shlyer detyrimet e taksave në shumën 52,651, mijë lekë, ndërsa për vitin 2013, nuk kanë shlyer detyrimet e taksave në shumën 79,311 mijë lekë.

Ndaj 339 subjekteve të cilët nuk janë regjistruar në QKR, nga policia Bashkiake dhe Zyra e taksave në Bashkinë Sarandë, nuk janë zbatuar procedurat e nevojshme ligjore të përcaktuar në ligjin nr. 9920, datë 10.05.2008 “Për Procedurat Tatimore”, ndryshuar me ligjin nr. 10415, datë 07.04.2011, neni 41- Identifikimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare pa u regjistruar.

Nuk ka asnjë dokumentacion për subjekte të transportit rrugor të cilët zhvillojnë aktivitet ekonomik ambulant të cilët nuk janë kontrolluar, mbasi janë në aktivitet të lëvizshëm.

Të gjitha përmbledhjet e sipërcituara tregojnë se nuk është bërë e mundur kryerja e funksionit të policisë së bashkisë, në bazë të pikës 3, 5, 6 të nenit 8, dhe nenet 11 dhe 13 të ligjit nr. 8224, datë 15.05.1997 “Për organizimin dhe funksionimin e policisë të bashkisë dhe të komunës”, me ndryshime. *(Trajtuar në pikën 11 të programit të raportit të auditimit faqet 249-257)*

Ë.B. me detyrë inspektor i INUV

V.Q. me detyrë inspektor i INUV

A.K. me detyrë inspektor i INUV dhe

A.A. me detyrë inspektor i INUV, pasi:

Janë gjobitur për vitin 2012 dhe 2013 në zbatim të nenit 88 dhe 89 të ligjit nr. 10119 “Për planifikimin e territorit”, 31 subjekte në vitin 2012 dhe 49 në vitin 2013 për vlerën 28,946,377 lekë, por nuk janë ndërmarrë hapa për arkëtimin e tyre pasi janë arkëtuar në 7 raste 1,913,967 lekë duke u mbetur pa arkëtuar 73 raste në vlerën prej 27,032,410 lekë, shumë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë.

Në librin e procesverbaleve që mban INUV janë evidentuar për kallëzime penale 14 persona, ndërsa drejtorisë juridike i janë dërguar për procedim për ndjekje penale vetëm për 10 persona, e cila nga ana e saj ka bërë kallëzimet në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Sarandë.

Nga auditimi i kryer rezulton se proces verbalët e konstatimit dhe vendimet e gjobave, nuk u janë dërguar kundërvajtësve me shkresë përcjellëse dhe nuk janë të protokolluar në zyrën e protokollit të Bashkisë. Në procesverbalin e konstatimit shënohet nuk u gjet në objekt, po kështu dhe gjoba nuk është e firmosur nga kundërvajtësi.

Mos vjeljen e gjobave në kundërshtim me ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve”, pasi bazuar në nenin 16 ekzekutimi i vendimeve për gjobat duhej të kërkohej në rrugë gjyqësore, nenin 84 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998 “Për urbanistikën” i ndryshuar, *(Ndryshuar me ligjin nr. 9843, datë 17.12.2007, neni 14)(Zëvendësuar fjalët me ligjin nr. 10078, datë 16.2.2009, neni 1), nenet 9, 22 dhe 30 të ligjit nr. 10279, datë 20.05.2010 “Për kundërvajtjet administrative” dhe pikën 16 të VKM nr. 862, datë 5.12.2007 “Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor” (Ndryshuar me vendim të KM nr .625, datë 28.7.2010),*

Vendimet e prishjes të objekteve ndërtimore të ndërtuara pa leje nuk janë shoqëruar në të gjitha raste edhe me vendime për dënim me gjobë e kallëzim penal, duke mos zbatuar pikën 1, 2, 4 dhe 8 të VKM nr. 862, datë 05.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai Vendor", në kundërshtim me nenin 15 paragrafi i fundit të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve", me ndryshime.

Konstatohet se në objektet që nuk janë prishur në një rast shprehet se janë ndërtuar 6 objekte me beton arme dhe blloqe, nga persona të pa identifikuar dhe në një rast janë ndërtuar 5 objekte 1 kat nga persona të pa identifikuar.

Në 3 raste, ku ka rezultuar se nuk janë pezulluar punimet subjekteve ndërtuese duke zbatuar dy standardeve, përveç se mostrajtim të barabartë të subjekteve për shkelje të njëjta, në kundërshtim me nenin 5 pika ç, të ligjit nr. 9780, datë 16.07.2007 "Për inspektimin e ndërtimit." dhe pikës 5 të VKM nr. 862, datë 5.12.2007 "Për unifikimin e procedurave të kontrollit të territorit nga Inspektorati ndërtimor e urbanistik kombëtar e ai vendor" (Ndryshuar me VKM nr. 625, datë 28.7.2010).

V.Xh. me detyrë Veteriner, pasi:

Nuk janë zbatuar përcaktimet e ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 "Për fondin kullosor", neni 15,17, 18, 29, 30, 33 dhe neni 34, pasi shkelja e këtyre dispozitave ka mundësuar mos ndjekjen e procedurave të konkurrimit, mos mbajtjen e akteve të kontrollit, mos përcaktimin në kontratë të kontureve të sipërfaqes, si dhe mos evidentimit të përdorimit apo jo të së njëjtës sipërfaqe të dhënë me qira apo përdorimit edhe të sipërfaqeve të tjera.

Nuk është zbatuar as UKM nr. 1, datë 02.7.2012 "Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor e kullosor publik".

Për të gjitha kontratat konstatohet se nuk ka ekstrakt nga QKR për objektin e veprimtarisë, si dhe dokument identifikimi të kërkuarit apo kërkuarve.

Kontratat nuk figurojnë të jenë protokolluar në zyrën e protokollit të institucionit, pasi asnjëra prej tyre nuk ka numër protokollit por vetëm datën dhe vulën e institucionit.

Për çdo kontratë nuk administrohet asnjë dokument shkresor, lidhur me miratimin nga këshilli i bashkisë të dhënies së sipërfaqes me qira dhe konfirmimi i aktit nga Prefekti.

Pronat nuk figurojnë të regjistruar në ZVRPP Sarandë, si dhe nuk evidentohet se sipas VKM-së, me çfarë numri rendor apo pasuror i korrespondon kalimi i saj në pronësi apo përdorim Bashkisë Sarandë.

Në asnjë rast nuk ka një genplan të pasurisë së dhënë me qira apo dhe kur ekziston një skicë ajo është fotokopje dhe e pa elementët teknikë identifikues, si dhe nuk është e miratuar nga titullari i bashkisë apo strukturat e tjera të ngarkuara prej tij, edhe pse në cdo kontratë citohet sipas hartës bashkëlidhur kësaj kontrate.

C.III. Mbështetur në nenin 58 "Llojet e masave disiplinore" dhe nenin 59 "Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore" të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 "Për nëpunësin civil" dhe VKM nr. 171, datë 26.3.2014 "Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirin nga shërbimi civil", i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë Sarandë dhënien e masës disiplinore parashikuar nga neni 58 i ligjit nr. 152/2013, për punonjësit si më poshtë:

P.H. me detyrë Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve, pasi:

Për moskryerjen e ndalesave në vlerën 6,335,832 lekë ndaj 7 subjekteve, për 10 raste sipas rekomandimeve të KLSH-së, diferenca zëra punimesh të pa kryera (Funksonimi dhe detyrat e drejtorit të Drejtorisë Shërbimeve) të Rregullores së Funksonimit të Brendshëm Administrativ të Bashkisë Sarandë dhe institucioneve në bashki).

Në 5 raste në vitin 2013 të kryerjes së prokurimeve publike me vlera të vogla ku u konstatua shmangie nga procedura elektronike dhe kalim në procedurë shkresore në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” si dhe të UAPP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar.

Në 13 raste nga ku 3 në vitin 2012 dhe 10 në vitin 2013 të realizimit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për punimet në infrastrukturë dhe ambientet publike, ku si rezultat i shpalljes fitues i personave fizik me vlerë oferte pa tvsh, si dhe preventiv me tvsh është lejuar që këto subjekte të përfitojnë padrejtësisht edhe tvsh-në në vlerën prej 1,026,409 lekë shumë e cila është shkelje e disiplinës financiare me pasojë mospërdorimin efektiv të fondeve buxhetore.

c. Zëri “*Heqja e mbetjeve inerte nga mjediset publike*” përkatësisht në vlerat **190,960 lekë, 80,301 lekë dhe 80,297 lekë** në preventivat e shërbimeve janë parashikuar në kundërshtim me kreun II, neni 5 të ligjit nr. 8094, datë 21.03.1996 “*Për largimin publik të mbeturinave*”, duke sjellë përfitim të padrejtë e të pamërituar nga operatori ekonomik, pasi këto shuma janë të paargumentuara dhe padokumentuara.

Ka lejuar që nga subjekti juridik privat “*I...*” sh.p.k. në vlerën prej **278,665 lekë**, për prokurimin “*Blerje naftë për nevojat e bashkisë Sarandë dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve*” për vitet 2012-2013, pasi në çmimin e kontratës është përfshirë edhe norma e fitimit 10 lekë për litër, vlerë e cila është në kundërshtim me vet ofertën e operatorit ekonomik fitues në të cilën nuk është përcaktuar norma e fitimit.

Ka lejuar që nga operatori ekonomik subjekt fizik “*E.D.*”, në vlerën prej **288,000 lekë**, për prokurimin “*Blerje automjet vetëshkarkues me kapacitet 2-3 ton për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike*”, pasi është bërë likuidimi me TVSH, në kundërshtim me ligjin me neni 1, pika 2/a nr. 7928 datë 27.4.1995 “*Për tatimin mbi vlerën e shtuar*”, i ndryshuar, pasi subjekti nuk është person i tatueshëm, duke i paguar padrejtësisht vlerën 288,000 lekë, si diferencën ndërmjet vlerës 1,440,000 leke pa TVSh dhe vlerës 1,728,000 lekë me tvsh.

Lidhur me dhënien me qira të aseteve të bashkisë nga ku ka rezultuar se për vitin 2012 nga 29 nga të cilat 21 kontrata të lidhura rishtazi dhe 8 të trashëguara në vlerën prej 4,929,980 lekë nuk janë paguar vlera e plotë e qirasë nga 9 subjekte në shumën prej 916,780 lekë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë, pa llogaritur dëmin ekonomik nga aplikimi i kushtit penal prej 0.5% të vlerës mujore të qirasë për secilin subjekt, sipas nenit 7 “Sanksione” të secilës kontratë, për subjektet që ende nuk kanë përmbushur këtë detyrim, i cili është 65,178 lekë.

Lidhur me dhënien me qira të aseteve të bashkisë nga ku ka rezultuar se për vitin 2013 nga 29 kontrata nga të cilat 17 kontrata të lidhura rishtazi dhe 12 të trashëguara në vlerën prej 4,737,366 lekë nuk janë paguar vlera e plotë e qirasë nga 12 subjekte në shumën prej 1,256,816 lekë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë, pa llogaritur dëmin ekonomik nga aplikimi i kushtit penal prej 0.5% të vlerës mujore të qirasë për secilin subjekt, sipas nenit 7 “Sanksione” të secilës kontratë, për subjektet që ende nuk kanë përmbushur këtë detyrim, i cili është 181,143 lekë.

Lidhur me hartimin dhe zbatimin e Kontratës nr. ska, datë 15.03.2012, “*Për dhënien me qira të objektit Lokal Riviera*”, dhe objekt kontrate e qëllim përdorimi “*Bar*”, me çmim prej 18,800 lekë

në muaj për objektin ose 225,600 sipërfaqen prej 188 m² “ndërtesë” dhe 150 m² verandë lekë në vit dhe për verandën 100 lekë për m²/muaj për 4 muaj dhe 15,000 lekë ose 60,000 lekë për 4 muaj, lidhur kontrata për 10 vite, nga ku është konstatuar një dëm ekonomik prej 225,600 lekë nga moszbatimi i VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kritereve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Kreu III, “Tarifat dhe Vlera DysHEME për Pasuritë Shtetërore që Jepen me Qira ose Enfiteozë”, ku është përcaktuar se vlera mujore e qirasë për ndërtesat është 150 lekë/m² në muaj, kurse nga bashkia kjo vlerë është vendosur në 100 lekë/m² në muaj.

Lidhur me zbatimin e Kontratës nr. ska, datë 01.05.2011, “Për dhënien me qira të objektit Pontili i ri” dhe objekt kontrate sipërfaqen prej 1400 m² truall i lirë dhe qëllim përdorimi “Lokal Shërbimi”, me çmim prej 140,000 lekë, lidhur kontrata për 20 vite, ku është konstatuar se sipërfaqja që përdor subjekti qiramarrës me sipërfaqen që ai realisht disponon është shumë e madhe, pasi nuk janë përfshirë 2 parcela në të cilat ky subjekt ofron shërbimin, të cilat përafërsisht rezultojnë të jenë mbi 500 m², nga ku mbi gjysma rezulton sipërfaqe e ndërtuar. Mosllogaritja e kësaj sipërfaqe përbën jo vetëm moszbatim të VKM nr. 529, datë 08.6.2011, por dhe një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Sarandë e cila llogaritet përafërsisht në afro 900,000 lekë në vit ose 2,700,000 për tri vite.

-Preventivimin pa projekt në kundërshtim me Ligjin nr, 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, neni 5 vlera 3.413.383 lekë me T.V.SH në 3 në investimet:

“Rikonstruksion Rruga hyrëse nr. 2 Berdenesh” vlera 2.999.669 lekë me T.V.SH.

“Asfaltim dhe ndriçim i rrugës B. Golemi” vlera 227.584 me T.V.SH.

“Rikonstruksion rrugësh, shtrim, ndriçim në pjesën e sipërme të qytetit, Lagja 3” vlera 186.131 me T.V.SH.

- Kolaudimin e punimeve të përfunduara nga ing. V.F. jo i pajisur me licence kolaudimi, por me licence zbatimi, kjo në 5 raste, në kundërshtim me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”, i ndryshuar në objektet:

“Restaurimi dhe ndërtimi i ambienteve në funksion të Zadrës së notit, faza II”

“Rikonstruksion rrugësh, shtrim, ndriçim në pjesën e sipërme të qytetit, Lagja 3”

“Rikonstruksion Rruga hyrëse nr. 2 Berdenesh”

- Preventivuar tepër në fond limit në kundërshtim me Vendimin Nr.514, datë 15.08.2007 “Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit” pika 2, 3 dhe 9 duke shkaktuar dëm ekonomik në vlerën 226.718 lekë pa T.V.SH. në investimin:

“Restaurimi dhe ndërtimi i ambienteve në funksion të Zadrës së notit, faza II” vlera 111,651 lekë pa T.V.SH.

-Për mangësi në dokumentacion në kundërshtim me UKM nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”” në 7 raste në procedurat e zbatimit të investimeve:

“Restaurimi dhe ndërtimi i ambienteve në funksion të Zadrës së notit, faza II”

“Rikonstruksion rrugësh, shtrim, ndriçim në pjesën e sipërme të qytetit, Lagja 3”

“Rikonstruksion Rruga hyrëse nr. 2 Berdenesh”

“Rikonstruksioni i varrezave të dëshmorëve”

“Rikonstruksion, shtrim rruge blloku i banimit Limion, Lagja 3”

“Restaurim e rritje e performancës së lulishtes Hasan Tahsini”

“Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me ujë për komunitetin (emergjenca)”

T.S. me detyrë Drejtore e Drejtorisë Ekonomike, pasi:

Për mosrakordim të punës me drejtoritë e tjera për vjeljen e detyrimeve të lëna nga KLSH-ja në kundërshtim me pikën 3 dhe 6 (Funksionimi dhe detyrat e drejtorit të Drejtorisë Ekonomike) të Rregullores së Funksionimit të Brendshëm Administrativ të Bashkisë Sarandë dhe institucioneve në bashki)

Pasi janë paguar 6 punonjës jo sipas diplomës që disponojnë, veprim në kundërshtim me kërkesat e lidhjes nr. 2, “Niveli i pagave për nëpunësit civil në bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe nëpunësit e komunave” dhe lidhja nr. 6, “Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar” të VKM nr. 518, datë 16.08.2012, VKM nr. 586, datë 17.07.2013, si dhe VKM nr. 553, datë 11.08.2011 duke përfituar shumën prej 904,152 lekë e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Në një rast lidhur me vendimit nr. 1222, datë 04.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në favor të kreditorit R.H. për shpërblim në pagë në vlerën 843,200 lekë nuk është ndjekur ecuria e procesit gjyqësor duke mos marrë pjesë në proces, si dhe duke mos u apeluar vendimi edhe pse nga Kryetari i kësaj njësie të qeverisjes vendore, është bërë një shënim drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë Juridike për nxjerrjen e përgjegjësisë, detyrë e cila nuk rezulton e realizuar.

Pasi në prokurimet me vlerë të vogël për blerje mallrash dhe kryerje shërbimesh në cilësinë e Kryetarit të Komisionit për periudhën 08.06.2012 deri më 31.12.2012, u konstatuan 35 raste në vitin 2012 dhe 4 raste në vitin 2013 ku ofertat e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në prokurim janë në datë para datës dhe mbas datës së testimit të tregut, raste kur nxjerrja e urdhër prokurimit dhe zhvillimi i procedurës janë formale sepse janë kryer mbasi mallrat kanë ardhur në magazinën e bashkisë, ofertat e operatorëve ekonomik pa vulë, pa numër nipt-i në disa raste të plotësuar dhe të firmosura nga një dorë, faturat e operatorit ekonomik në datë disa ditë mbas shpalljes së tij si fitues, fatura e operatorit ekonomik fitues të pa firmosur nga anëtarët e komisionit të prokurimit, fletëhyrja e mallrave në magazinë disa ditë mbas datës së faturës së operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me kërkesat e shkronjës “c”, pika 2, kreu i VI-të, të VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, “Për rregullat e prokurimit publik” si dhe të pikës 5, të UAPP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar.

Në 5 raste në vitin 2013 të kryerjes së prokurimeve publike me vlera të vogla ku u konstatua shmangie nga procedura elektronike dhe kalim në procedurë shkresore në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” si dhe të UAPP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar.

Në 13 raste nga ku 3 në vitin 2012 dhe 10 në vitin 2013 të realizimit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për punimet në infrastrukturë dhe ambientet publike, ku si rezultat i shpalljes fitues i personave fizik me vlerë oferte pa tvsh, si dhe preventiv me tvsh është lejuar që këto subjekte të përfitojnë padrejtësisht edhe tvsh-në në vlerën prej 1,026,409 lekë shumë e cila është shkelje e disiplinës financiare me pasojë mospërdorimin efektiv të fondeve buxhetore.

Në 5 raste me urdhërshpenzime të bëra nga artikulli 600 dhe 602 “Shpenzime operative”, për shpenzime pritje e përcjellje, në vlerën prej 986,943 lekë janë përballuar shpenzime për koktej, në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.1999, “Për shpenzime pritje e përcjellje dhe trajtim që u bëhet delegacioneve të huaja”, të cilat konsiderohen në shkelje të disiplinës financiare me pasojë mospërdorimin efektiv të fondeve buxhetore.

Pasi në 5 raste, në drejtim të shpenzimeve të bëra nga artikulli 602 “Shpenzime operative” për shpenzime pritje e përcjellje nga artikulli 602, janë përballuar shpenzime për koktej me rastin e 7-8 Marsit, me rastin e miratimit të buxhetit të vitit 2012 dhe me rastin e 20 vjetorit të krijimit të Bashkisë Sarandë, në vlerën prej 986,943 lekë, shpenzime këto të likuiduara në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.199, “Për shpenzime pritje e përcjellje dhe trajtim që u bëhet delegacioneve të huaja”, në shkelje të disiplinës financiare me pasojë mospërdorimin efektiv të fondeve buxhetore.

Ka lejuar që nga operatori ekonomik subjekt fizik “E.D.”, në vlerën prej **288,000 lekë**, për prokurimin “Blerje automjet vetëshkarkues me kapacitet 2-3 ton për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike”, pasi është bërë likuidimi me TVSH, në kundërshtim me ligjin me neni 1, pika 2/a nr. 7928 datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, pasi subjekti nuk është person i tatueshëm, duke i paguar padrejtësisht vlerën 288,000 lekë, si diferencën ndërmjet vlerës 1,440,000 leke pa TVSh dhe vlerës 1,728,000 lekë me tvsh.

Pasi është vepruar në kundërshti me Kapitullin III “Regjistri i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre”, pika 26 dhe 27 të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik”, nëpunësi autorizues nuk ka caktuar nëpunësin zbatues për krijimin dhe mbajtjen e regjistrit kontabël të të gjithë aktiveve që zotëron apo ka në administrim.

Po ashtu në kundërshtim me nenin 31/d, nuk është mbajtur regjistri i veçantë për secilën nga pasuritë e dhëna me qira ku të përcaktohet sipërfaqja e objektit në metra katrorë, numri dhe data e kontratës së qirasë, afati i vlefshmërisë së kontratës, afati i qirasë, veprimtaria që kryhet, subjekti përfitues, qiraja mujore dhe arkëtimet sipas muajve të vitit kalendarik.

Në kundërshtim me kërkesën e nenit 69, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011, listprezencat e muajit Janar e Shkurt të vitit 2014, të pjesëmarrjes në punë të punonjësve të administratës së Bashkisë, është paguar në mënyrë të kundraligjshme në shkelje të disiplinës financiare me dëm efektiv, për vlerën neto 43,338 lekë, pasi rezulton se nuk ka qenë në punë gjatë kësaj periudhe.

Janë paguar 4 punonjës mbi numrin e miratuar strukturën organike dhe numrin e punonjësve të Administratës së Bashkisë, të miratuar me VKB nr.75, datë 20.01.2014, duke shkaktuar buxhetit të shtetit një dëm financiar në vlerën 173,600 lekë neto.

Z. E.Gj. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Juridike, pasi:

*Pasi në Akt paditë në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Sarandë dhe të gjitha shkallët e gjyqësorit, për zhdëmtimet nga subjektet të detyrimeve, institucioni është paraqitur me urdhër zhdëmtim, ndërsa duhet me Akt Administrativ, sipas nenit 1, neni 2, Fusha e zbatimit ku theksohet se: *parimet e përgjithshme të këtij kodi, mund të bëhen të detyrueshme për zbatim edhe për veprimtarinë e subjekteve private kur këto veprimtari kanë efekte për interesat publike* dhe nenet 116, 117 të Ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999 “Kodi i Procedurave Administrative ku citohet: *Kur akti është nxjerrë në kundërshtim me formën dhe procedurën e kërkuar nga ligji, si dhe në qoftë se një pjesë e aktit është absolutisht e pavlefshme, i gjithë akti konsiderohet absolutisht i pavlefshëm.**

Pasi janë paguar 6 punonjës jo sipas diplomës që disponojnë, veprim në kundërshtim me kërkesat e lidhjes nr. 2, “Niveli i pagave për nëpunësit civil në bashkitë e tjera, njësitë bashkiake të Tiranës dhe nëpunësit e komunave” dhe lidhja nr. 6, “Vlera e pagës së grupit për grupet e diplomave të arsimit universitar” të VKM nr. 518, datë 16.08.2012, VKM nr. 586, datë 17.07.2013, si dhe VKM nr. 553, datë 11.08.2011 duke përfituar shumë prej 904,152 lekë e cila përbën shkelje të disiplinës financiare me pasojë dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.

Në një rast lidhur me vendimit nr. 1222, datë 04.10.2012 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Sarandë, në favor të kreditorit R.H. për shpërblim në pagë në vlerën 843,200 lekë nuk është ndjekur ecuria e procesit gjyqësor duke mos marrë pjesë në proces, si dhe duke mos u apeluar vendimi edhe pse nga Kryetari i kësaj njësie të qeverisjes vendore, është bërë një shënim drejtuar Drejtorisë Ekonomike dhe Drejtorisë Juridike për nxjerrjen e përgjegjësisë, detyrë e cila nuk rezultoi e realizuar.

Në 13 raste nga ku 3 në vitin 2012 dhe 10 në vitin 2013 të realizimit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për punimet në infrastrukturë dhe ambientet publike, ku si rezultat i shpalljes fitues i personave fizik me vlerë oferte pa tvsh, si dhe preventiv me tvsh është lejuar që këto subjekte të përfitojnë padrejtësisht edhe tvsh-në në vlerën prej 1,026,409 lekë shumë e cila është shkelje e disiplinës financiare me pasojë mospërdorimin efektiv të fondeve buxhetore. *(Trajtuar në pikën 5 të programit të raportit të auditimit faqet 48-55)*

Ka lejuar që nga subjekti juridik privat “I...” sh.p.k. në vlerën prej **278,665 lekë**, për prokurimin “Blerje naftë për nevojat e bashkisë Sarandë dhe Ndërmarrjes së Shërbimeve” për vitet 2012-2013, pasi në çmimin e kontratës është përfshirë edhe norma e fitimit 10 lekë për litër, vlerë e cila është në kundërshtim me vet ofertën e operatorit ekonomik fitues në të cilën nuk është përcaktuar norma e fitimit.

Ka lejuar që nga operatori ekonomik subjekt fizik “E.D.”, në vlerën prej **288,000 lekë**, për prokurimin “Blerje automjet vetëshkarkues me kapacitet 2-3 ton për Ndërmarrjen e Shërbimeve Publike”, pasi është bërë likuidimi me TVSH, në kundërshtim me ligjin me neni 1, pika 2/a nr. 7928 datë 27.4.1995 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, i ndryshuar, pasi subjekti nuk është person i tatueshëm, duke i paguar padrejtësisht vlerën 288,000 lekë, si diferencën ndërmjet vlerës 1,440,000 leke pa TVSh dhe vlerës 1,728,000 lekë me tvsh.

Nuk ka përcaktuar saktë ndarjen e sipërfaqeve të tabelave të reklamave për shoqërinë “A...” sh.p.k. dhe për mos kërkesën e llogarisë për zbatimin e kontratave të lidhura duke mundësuar që shoqëria të përfitojë nga mos kryerja e pagesave të sipërfaqeve të reklamave të vendosura mbi sipërfaqet e përcaktuara në kontratë në shumën 3,530,320 lekë.

Për dëmin prej 582,000 lekë, shkaktuar nga lidhja e dy kontratave për zënie e hapësirave publike për vendosjen e tabelave me shoqërinë “A...” sh.p.k., për të njëjtat sipërfaqe por me vlera të ndryshme të kontratave nr. *ska* datë 26.03.2012, nr. 26.03.2013 dhe 11.03.2014, në kundërshtim me nenin 1 dhe 11 të kontratës datë 26.03.2013 dhe me VKB nr. 43, datë 22.12.2011”Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2012.

Nuk janë zbatuar përcaktimet e ligjit nr. 9693, datë 19.3.2007 “Për fondin kullosor”, neni 15,17, 18, 29, 30, 33 dhe nenit 34, pasi shkelja e këtyre dispozitave ka mundësuar mos ndjekjen e procedurave të konkurrimit, mos mbajtjen e akteve të kontrollit, mos përcaktimin në kontratë të kontureve të sipërfaqes, si dhe mos evidentimit të përdorimit apo jo të së njëjtës sipërfaqe të dhënë me qira apo përdorimit edhe të sipërfaqeve të tjera.

Nuk është zbatuar as UKM nr. 1, datë 02.7.2012 “Për përcaktimin e kriterëve të konkurrimit dhe procedurën e dhënies në përdorim me kontratë qiraje të fondit pyjor e kullosor publik”.

Për të gjitha kontratat konstatohet se nuk ka ekstrakt nga QKR për objektin e veprimtarisë, si dhe dokument identifikimi të kërkuarit apo kërkuarve.

Kontratat nuk figurojnë të jenë protokolluar në zyrën e protokollit të institucionit, pasi asnjëra prej tyre nuk ka numër protokollit por vetëm datën dhe vulën e institucionit.

Për çdo kontratë nuk administrohet asnjë dokument shkresor, lidhur me miratimin nga këshilli i bashkisë të dhënies së sipërfaqes me qira dhe konfirmimi i aktit nga Prefekti.

Pronat nuk figurojnë të regjistruar në ZVRPP Sarandë, si dhe nuk evidentohet se sipas VKM-së, me çfarë numri rendor apo pasuror i korrespondon kalimi i saj në pronësi apo përdorim Bashkisë Sarandë.

Në asnjë rast nuk ka një genplan të pasurisë së dhënë me qira apo dhe kur ekziston një skicë ajo është fotokopje dhe e pa elementët teknikë identifikues, si dhe nuk është e miratuar nga titullari i bashkisë apo strukturat e tjera të ngarkuara prej tij, edhe pse në cdo kontratë citohet sipas hartës bashkëlidhur kësaj kontrate.

Lidhur me dhënien me qira të aseteve të bashkisë nga ku ka rezultuar se për vitin 2012 nga 29 nga të cilat 21 kontrata të lidhura rishtazi dhe 8 të trashëguara në vlerën prej 4,929,980 lekë nuk janë paguar vlera e plotë e qirasë nga 9 subjekte në shumën prej 916,780 lekë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë, pa llogaritur dëmin ekonomik nga aplikimi i kushtit penal prej 0.5% të vlerës mujore të qirasë për secilin subjekt, sipas nenit 7 “Sanksione” të secilës kontratë, për subjektet që ende nuk kanë përmbushur këtë detyrim, i cili është 65,178 lekë.

Lidhur me dhënien me qira të aseteve të bashkisë nga ku ka rezultuar se për vitin 2013 nga 29 kontrata nga të cilat 17 kontrata të lidhura rishtazi dhe 12 të trashëguara në vlerën prej 4,737,366 lekë nuk janë paguar vlera e plotë e qirasë nga 12 subjekte në shumën prej 1,256,816 lekë e cila përbën të ardhur të munguar për Bashkinë Sarandë, pa llogaritur dëmin ekonomik nga aplikimi i kushtit penal prej 0.5% të vlerës mujore të qirasë për secilin subjekt, sipas nenit 7 “Sanksione” të secilës kontratë, për subjektet që ende nuk kanë përmbushur këtë detyrim, i cili është 181,143 lekë.

Lidhur me hartimin dhe zbatimin e Kontratës nr. ska, datë 15.03.2012, “Për dhënien me qira të objektit Lokal Riviera” dhe objekt kontrate e qëllim përdorimi “Bar”, me çmim prej 18,800 lekë në muaj për objektin ose 225,600 sipërfaqen prej 188 m² “ndërtesë” dhe 150 m² verandë lekë në vit dhe për verandën 100 lekë për m²/muaj për 4 muaj dhe 15,000 lekë ose 60,000 lekë për 4 muaj, lidhur kontrata për 10 vite, nga ku është konstatuar një dëm ekonomik prej 225,600 lekë nga moszbatimi i VKM nr. 529, datë 08.6.2011 “Për përcaktimin e kriterëve, të procedurës dhe të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore”, Kreu III, “Tarifat dhe Vlera DysHEME për Pasuritë Shtetërore që Jepen me Qira ose Enfiteozë”, ku është përcaktuar se vlera mujore e qirasë për ndërtesat është 150 lekë/m² në muaj, kurse nga bashkia kjo vlerë është vendosur në 100 lekë/m² në muaj.

Lidhur me zbatimin e Kontratës nr. ska, datë 01.05.2011, “Për dhënien me qira të objektit Pontili i ri” dhe objekt kontrate sipërfaqen prej 1400 m² truall i lirë dhe qëllim përdorimi “Lokal Shërbimi”, me çmim prej 140,000 lekë, lidhur kontrata për 20 vite, ku është konstatuar se sipërfaqja që përdor subjekti qiramarrës me sipërfaqen që ai realisht disponon është shumë e madhe, pasi nuk janë përfshirë 2 parcela në të cilat ky subjekt ofron shërbimin, të cilat për afërsisht rezultojnë të jenë mbi 500 m², nga ku mbi gjysma rezulton sipërfaqe e ndërtuar. Mosllogaritja e kësaj sipërfaqe përbën jo vetëm moszbatim të VKM nr. 529, datë 08.6.2011, por dhe një dëm ekonomik për buxhetin e Bashkisë Sarandë e cila llogaritet për afërsisht në afro 900,000 lekë në vit ose 2,700,000 për tri vite.

C.IV. Mbështetur në nenin 58 “Llojet e masave disiplinore” dhe nenin 59 “Kompetencat dhe procedurat për masat disiplinore” të ligjit nr. 152/2013, datë 30.05.2013 “Për nëpunësin civil” dhe VKM nr. 171, datë 26.3.2014 “Për transferimin e përhershëm dhe të përkohshëm të nëpunësve civilë, pezullimin dhe lirimin nga shërbimi civil”, i kërkojmë Kryetarit të Bashkisë

Sarandë dhënien e masës disiplinore “**vërejtje**” parashikuar nga neni 58 pika b e ligjit nr. 152/2013, për punonjësit si më poshtë:

H.K. me detyrë Drejtor i Drejtorisë Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit të Territorit, pasi:

Për mosndjekje të shlyerjes së detyrimeve të taksës në infrastrukturë të subjekteve të ndërtimit, si dhe për mosrakordim të punës me drejtorinë Ekonomike dhe të Taksave në bashki, në kundërshtim me pikën 8 (Funksionimi dhe detyrat e drejtorit të Drejtorisë urbanistikës) të Rregullores së Funksionimit të Brendshëm administrativ të Bashkisë Sarandë dhe institucioneve në bashki), mbasi 1 subjekt edhe pse nuk ka shlyer detyrimet ka marrë pjesë në prokurime dhe ka fituar tenderin Sipërmarrësi “Jody Kompany”, pa likuiduar vlerën 1,694,140 lekë, veprim në kundërshtim me kreu II “Organizimi i Prokurimit Publik”, neni 12 i ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, me ndryshimet si dhe kreu V “Zhvillimi i procedurave” të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, me ndryshimet.

Për 4 raste nga ku rezulton se Leja e sheshit dhe kondicioneve urbane të tij është pa kërkesë (formulari nr. 1), në kundërshtim me nenet 38 e 40 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998.

Në të 4 rastet rezulton se nuk janë parashikuar vendeve parkimi në kundërshtim me VKM nr. 722, datë 19.11.1998, pika 85.

Për 4 raste nga ku rezulton se nuk ka kërkesë për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, , si dhe mungon mendimi i zyrës së urbanistikës dhe këshillit teknik për miratimin e studimit urbanistik pjesor, në kundërshtim me VKM 722, datë 19.11.1998, e ndryshuar, pika 53.

Për 4 raste nga ku rezulton se nuk ka kërkesë për miratimin e lejes të ndërtimit, në kundërshtim me neni 45 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998.

Për 4 raste nga ku rezulton se në dosje nuk ka Studim Urbanistik Pjesor, veprim, në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998, neni 20, pika 2, germa “a” dhe Rregulloren e Urbanistikës të miratuar me VKM nr. 722, datë 19.11.1998, pika 47 si dhe pika 48.

Për 4 raste nga ku rezulton se nuk është përllogaritur Intensiteti i ndërtimit sipas tabelës 4 të pikës 91 të Rregullores së Urbanistikës nr. 722, datë 19.11.1998.

Për 4 raste nga ku rezulton se në dosje nuk ka mendimi të zyrës së urbanistikës dhe këshillit teknik për miratimin e lejes së ndërtimit.

Për 1 rast nga ku rezulton se në dosje mungon leja, autorizimi apo pëlqimi mjedisor, në kundërshtim me ligjin nr. 8934, datë 05.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisin”, ligjin nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” neni 1.

Pasi në të gjitha rastet e audituara, në dosjet përkatëse të lejeve të ndërtimit nuk kishte një listë të dokumentacionit të ndodhur në të, të pa inventarizuar, pa vendosur numrin në çdo fletë dhe të pa arkivuara, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregullores së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 480, datë 22.6.2011, neni 10 “Kushtet për zhvillim” , pika 11 e cila përcakton se “Infrastruktura e nevojshme që mundëson funksionimin e një zhvillimi të ri dhe e lidh zhvillimin e ri me rrjetet ekzistuese të infrastrukturave, realizohet nga zhvilluesi dhe leja e përdorimit jepet vetëm pasi kjo infrastrukturë regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi”, pasi nuk ka certifikatë apo vërtetim pronësor të lëshuar nga ZVRPP Sarandë.

Pasi mungon inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe rregullorja e nxjerrë në zbatim të tij.

Për punonjësit e Drejtorisë Planifikimit dhe Kontrollit të Zhvillimit, sipas kompetencave e përgjegjësiwe përkatëse dhe konkretisht:

A.S. me detyrë Specialist të Zyrës së Projektimit,

Z.P. dhe E.F. me detyrë Specialist të Zyrës të Kadastrës Urbane,

Gj.Zh. me detyrë Specialist të Zyrës të Urbanistikës Ligjore

V.F. dhe me detyrë Specialist të Zyrës të Urbanistikës Ligjore

V.T. me detyrë Specialist të Zyrës të Urbanistikës Ligjore,

T.H. specialist i Zyres së Infstrukturës

Për 4 raste nga ku rezulton se Leja e sheshit dhe kondicioneve urbane të tij është pa kërkesë (formulari nr. 1), në kundërshtim me nenet 38 e 40 të ligjit nr. 8405, datë 17.9.1998.

Në të 4 rastet rezulton se nuk janë parashikuar vendeve parkimi në kundërshtim me VKM nr. 722, datë 19.11.1998, pika 85.

Për 4 raste nga ku rezulton se nuk ka kërkesë për miratimin e destinacionit të sheshit të ndërtimit dhe kondicioneve urbane të tij në kundërshtim me nenin 40 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998, , si dhe mungon mendimi i zyrës së urbanistikës dhe këshillit teknik për miratimin e studimit urbanistik pjesor, në kundërshtim me VKM 722, datë 19.11.1998, e ndryshuar, pika 53.

Për 4 raste nga ku rezulton se nuk ka kërkesë për miratimin e lejes të ndërtimit, në kundërshtim me neni 45 të ligjit nr. 8405, datë 17.09.1998.

Për 4 raste nga ku rezulton se në dosje nuk ka Studim Urbanistik Pjesor, veprim, në kundërshtim me ligjin nr. 8405, datë 17.09.1998, neni 20, pika 2, germa “a” dhe Rregulloren e Urbanistikës të miratuar me VKM nr. 722, datë 19.11.1998, pika 47 si dhe pika 48.

Për 4 raste nga ku rezulton se nuk është përllogaritur Intensiteti i ndërtimit sipas tabelës 4 të pikës 91 të Rregullores së Urbanistikës nr. 722, datë 19.11.1998.

Për 4 raste nga ku rezulton se në dosje nuk ka mendimi të zyrës së urbanistikës dhe këshillit teknik për miratimin e lejes së ndërtimit.

Për 1 rast nga ku rezulton se në dosje mungon leja, autorizimi apo pëlqimi mjedisor, në kundërshtim me ligjin nr. 8934, datë 05.9.2002 “Për mbrojtjen e mjedisin”, ligjin nr. 8990, datë 23.01.2003 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” neni 1.

Pasi në të gjitha rastet e audituara, në dosjet përkatëse të lejeve të ndërtimit nuk kishte një listë të dokumentacionit të ndodhur në të, të pa inventarizuar, pa vendosur numrin në çdo fletë dhe të pa arkivuara, në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe Rregullores së Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave.

Nuk ka gjetur zbatim VKM nr. 480, datë 22.6.2011, neni 10 “Kushtet për zhvillim” , pika 11 e cila përcakton se “Infrastruktura e nevojshme që mundëson funksionimin e një zhvillimi të ri dhe e lidh zhvillimin e ri me rrjetet ekzistuese të infrastrukturave, realizohet nga zhvilluesi dhe leja e përdorimit jepet vetëm pasi kjo infrastrukturë regjistrohet në Regjistrin e Pasurive të Paluajtshme, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi”, pasi nuk ka certifikatë apo vërtetim pronësor të lëshuar nga ZVRPP Sarandë.

Pasi mungon inventarizimi dhe arkivimi i dosjeve në kundërshtim me ligjin nr. 9154, datë 06.11.2003 “Për arkivat” dhe rregullorja e nxjerrë në zbatim të tij.

E.C, me detyrë Specialist nw Drejtoriwn e Shwrbimeve, pasi:

Në 5 raste në vitin 2013 të kryerjes së prokurimeve publike me vlera të vogla ku u konstatua shmangie nga procedura elektronike dhe kalim në procedurë shkresore në kundërshtim me

VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” si dhe të UAPP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar.

Në 13 raste nga ku 3 në vitin 2012 dhe 10 në vitin 2013 të realizimit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për punimet në infrastrukturë dhe ambientet publike, ku si rezultat i shpalljes fitues i personave fizik me vlerë oferte pa tvsh, si dhe preventiv me tvsh është lejuar që këto subjekte të përfitojnë padrejtësisht edhe tvsh-në në vlerën prej 1,026,409 lekë shumë e cila është shkelje e disiplinës financiare me pasojë mospërdorimin efektiv të fondeve buxhetore.

E.P. me detyrë Specialist nw Drejtorin e Shërbimeve, pasi:

Në 5 raste në vitin 2013 të kryerjes së prokurimeve publike me vlera të vogla ku u konstatua shëmbëllje nga procedura elektronike dhe kalim në procedurë shkresore në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik” si dhe të UAPP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar.

Në 13 raste nga ku 3 në vitin 2012 dhe 10 në vitin 2013 të realizimit të procedurave të prokurimit me vlerë të vogël për punimet në infrastrukturë dhe ambientet publike, ku si rezultat i shpalljes fitues i personave fizik me vlerë oferte pa tvsh, si dhe preventiv me tvsh është lejuar që këto subjekte të përfitojnë padrejtësisht edhe tvsh-në në vlerën prej 1,026,409 lekë shumë e cila është shkelje e disiplinës financiare me pasojë mospërdorimin efektiv të fondeve buxhetore.

Pasi në 5 raste, në drejtim të shpenzimeve të bëra nga artikulli 602 “Shpenzime operative” për shpenzime pritje e përcjellje nga artikulli 602, janë përballuar shpenzime për koktej me rastin e 7-8 Marsit, me rastin e miratimit të buxhetit të vitit 2012 dhe me rastin e 20 vjetorit të krijimit të Bashkisë Sarandë, në vlerën prej 986,943 lekë, shpenzime këto të likuiduara në kundërshtim me VKM nr. 243, datë 15.05.199, “Për shpenzime pritje e përcjellje dhe trajtim që u bëhet delegacioneve të huaja”, në shkelje të disiplinës financiare me pasojë mospërdorimin efektiv të fondeve buxhetore.

Për punonjësit e Drejtorisë së Taksave dhe të Ardhurave Vendore:

M.Shahini, me detyrë Inspektore Regjistrimit,

Zh.R. me detyrë Inspektore Regjistrimi,

B.M. me detyrë Inspektore Kontabiliteti,

E.Dh. me detyrë Inspektor Hetimi Tatimor,

N.A. me detyrë Inspektore Kontrolli,

A.K. me detyrë Inspektor Kontrolli,

E.G. me detyrë Inspektor Kontrolli,

R.M. me detyrë Inspektore Kontrolli,

S.I. me detyrë Inspektore Kontrolli, dhe

L.K. me detyrë Inspektore Kontrolli, pasi:

Në fund të vitit 2013, janë konstatuar 1202 subjekte fizike e juridike debitor me vlerën 75,707,033 lekë. Subjekte tregu 77 në vlerën 558,203 lekë dhe Subjekte të tokës bujqësore 814, në vlerën 3,046,237 lekë.

Në listën e debitorëve të vitit 2012 dhe 2013, rezulton që nuk janë vendosur gjopa në masën deri në 25 përqind, për detyrimin e pa arkëtuar në afatin ligjor.

Administrata tatimore nuk ka mundur që debitorët e vitit 2012, që janë 1701 subjekte në vlerën 55,651,358 lekë, ti detyrojë që të paguajnë detyrimin gjatë vitit 2013, por sipas listave të

debitorëve të vitit 2013 rezulton se janë 2093 subjekte në total në vlerën 79,311,473 lekë, duke sjellë për pasojë rritjen e debitorëve në 392 raste në vlerën 23,660,115 lekë dhe jo pakësimin e tyre.

Janë nxjerrë listat për subjektet debitorë për pagesën e detyrimeve, por nuk i janë dërguar zyrtarisht Policisë Bashkiake dhe Zyrës së Financës, nuk është raportuar e nuk i është kërkuar Këshillit Bashkiak Sarandë ndërhyrje me forcë e Policisë Bashkiake, për vjeljen e subjekteve debitorë, siç parashikohet në nenin 5, germa “ç” nënpika “iii”, të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”.

Për subjektet debitorë nuk i është kërkuar, *Drejtorisë Rajonale të Transportit, vendosja e bares siguruese (për mjetet)*, duke shkelur ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore” dhe konkretisht në nenin 91.

Për arkëtimin e këtyre detyrimeve janë mjaftuar vetëm me dërgimin e shkresave në subjekt pa ndërmarrë veprime të tjera ligjore si ndërhyrje me forcë të mbylljes të aktivitetit, vendosjen gjobave, sekuestrimin e mallit dhe denoncimin në prokurori, duke sjellë për pasojë rritjen e detyrimeve fiskale nga viti në vit, po ashtu edhe maturimet.

Për dosjet e subjekteve të hotelierisë janë konstatuar praktika ku Dosje që s’kanë asnjë dokumentacion, me përjashtim të njoftimeve të vlershmit të detyrimit janë 54, dosje që kanë vërtetimin e Hipotekës 16, dosje që kanë vetëm Gent Planet 14, dosje që kanë vetëm Procesverbale 10; tregues se se vendosja e maturimit për sipërfaqet e ndërtesave, sipërfaqet e zënies të hapësirave publike, nr. e dhomave, është përcaktuar në mënyrë fiktive.

Nuk është ngritur një grup pune me mbështetje të policisë bashkiake për të verifikuar në çdo subjekt sipërfaqet e zaptuar në hapësirat publike e në veçanti plazhet, në referim të VKM nr. 358, datë 01.06.2012, “Për sigurinë”.

Në dosjet e subjekteve të hotelierisë në asnjë rast nuk u gjenden kërkesat e subjekteve për ndryshim të maturimit, si dhe nuk u gjenden, Njoftimet e Vlerësimit tatimor të bëra nga vet zyra Numri i hoteleve të regjistruar me atë faktik është jo real, pasi në bashkinë Sarandë për vitin 2011, janë të regjistruar 103 subjekte hotelierie, nga këta janë debitor 74 subjekte, në vlerën 9,299,727 lekë, për vitin 2012, janë të regjistruar 94 subjekte hotelierie, nga ku debitor 69 subjekte në vlerën 14,342,723 lekë, dhe për vitin 2013, janë të regjistruar 96 subjekte hotelierie, nga këta janë debitor 71 subjekte në vlerën 19,771,780 lekë, si dhe për 18 subjekte hotelierie që vazhdojnë aktivitetin e tyre rregullisht kanë një detyrim 12,071,462 lekë.

Veprime në kundërshtim me Rregulloren e Brendshme “Për organizimin, funksionimin, detyrat dhe kompetencat e administratës së Bashkisë”, miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak Sarandë, nr. 88 datë 17.07.2008, neni 4, Detyrat e Drejtorisë së të ardhurave lokale, neni 5, Detyrat e Drejtorit të Drejtorisë së të ardhurave lokale, si dhe nenin 1 dhe 11 të kontratës datë 26.03.2013, me VKB nr. 43, datë 22.12.2011”Për miratimin e paketës fiskale për vitin 2012 dhe ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore” me ndryshime.

L.C. me detyrë Specialist i Shërbimeve, pasi:

Pasi në prokurimet me vlerë të vogël për blerje mallrash dhe kryerje shërbimesh në cilësinë e Anëtarit të Komisionit, u konstatuan 35 raste në vitin 2012 dhe 4 raste në vitin 2013 ku ofertat e operatorëve ekonomik pjesëmarrës në prokurim janë në datë para datës dhe mbas datës së testimit të tregut, raste kur nxjerrja e urdhër prokurimit dhe zhvillimi i procedurës janë formale sepse janë kryer mbasi mallrat kanë ardhur në magazinën e bashkisë, ofertat e operatorëve ekonomik pa vulë, pa numër nipt-i në disa raste të plotësuar dhe të firmosura nga një dorë,

faturat e operatorit ekonomik në datë disa ditë mbas shpalljes së tij si fitues, fatura e operatorit ekonomik fitues të pa firmosur nga anëtarët e komisionit të prokurimit, fletëhyrja e mallrave në magazinë disa ditë mbas datës së faturës së operatorit ekonomik fitues, në kundërshtim me kërkesat e shkronjës “c”, pika 2, kreu i VI-të, të VKM nr.1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, “Për rregullat e prokurimit publik” si dhe të pikës 5, të UAPP nr. 2, datë 18.02.2008 “Për procedurën e prokurimit me vlera të vogla”, i ndryshuar.

Ll.D. me detyrë Drejtor i Programim Zhvillimit Vendor dhe

Z.K. me detyrë Specialist për Shkrimin e Aplikimin e Projekteve dhe Menaxhimin e Pronave të Bashkisë, pasi:

Rezulton se mbi 30% e vendstrehime nuk ekzistojnë më fizikish por janë të përfshira në totalin prej 81 vendstrehimeve të cilat janë inventarizuar dhe kërkuar të kalojnë në pronësi të njësisë vendore, tregues se lista i inventarit të pasurive të paluajtshme të miratuara nga këshilli bashkia dhe që janë në pritje për miratim nga KM, nuk është aspak real, dhe nuk është bërë mbi bazën e verifikimeve në terren, duke dëshmuar se nga strukturat përgjegjëse nuk është vlerësuar sa duhet ky proces.

D. MASA ADMINISTRATIVE

Referuar parregullsive dhe shkeljeve të ndryshme të konstatuara në prokurimet publike për periudhën 01.01.2012 deri më 31.12.2013, si dhe përgjegjësisë individuale të evidentuar dhe pasqyruar në raportin përfundimtar të auditimit, bazuar në nenin 13 (pika “i”) dhe 72, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” i ndryshuar, dhe pikës 3, kreut X të VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, i kërkojmë **Titullari i Autoritetit Kontraktor**, të vlerësojë shkeljet e konstatuara dhe marrjen e masave administrative dhe disiplinore për punonjësit si më poshtë:

- 1. V.V. në cilësinë e anëtares së Njesisë së prokurimit,**
- 2. E.Gj. në cilësinë e anëtarit të Njesisë së prokurimit,**
- 3. E.C. në cilësinë e anëtarit të Njesisë së prokurimit,**
- 4. E.L. në cilësinë e anëtarit të Njesisë së prokurimit,**
- 5. H.K. në cilësinë e anëtarit të Njesisë së prokurimit.**

Për arsye se:

Nuk kanë dorëzuar në Agjencinë e Prokurimit Publik raporte për veprimtarinë e prokurimit të autoritetit kontraktor, sipas formatit dhe përmbajtjes së përcaktuar në rregullat e prokurimit, në kundërshtim me pikën 4 të nenit 12 të ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”. Kanë mangësi në përcaktimet dhe miratimet e kriterëve të veçanta të kualifikimit, pasi kriteret e përdorura për identifikimin e ofertës ekonomikisht më të favorshme nuk i plotësojnë kushtet e nenit 55, pika 1, e LPP-së, pasi nuk janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës; nuk janë objektive, përpjesëtimore me kontratën objekt prokurimi; nuk janë të përcaktuara qartë në njoftimin e kontratës apo në dokumentet e tenderave.

Nuk janë specifikuar në mënyrë të saktë nga ana e autoritetit kontraktor kriteret e përdorura për vlerësimin e ofertave, për rrjedhojë lejojnë Komisionin e Vlerësimit të Ofertave, t’i interpretojnë

ato në mënyra të ndryshme në proceduar të ndryshme madje në të gjitha rastet në dëm të autoritetit kontraktor.

Nuk kanë argumentim me hollësi të kriterëve të kualifikimit, në kundërshtim me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, i ndryshuar, Kreu III, pika 3, germa “a” si dhe me nenin nr. 46 të LPP-së, pikën nr. 3.

Nuk janë dhënë argumentime mbi vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, në kundërshtim me Rregullat e Prokurimit Publik, të miratuara me VKM nr. 1, datë 10.01.2007, kreu V, i ndryshuar, në të cilin përcaktohet se, për vendosjen e çdo kriteri për kualifikim, të parashikuar në LPP dhe në këto rregulla, njësia duhet të argumentojë me hollësi vendosjen e tyre, sipas natyrës dhe vëllimit të kontratës, duke nxitur pjesëmarrjen e Operatorëve Ekonomik, veçanërisht biznesit të vogël. Kërkesa të tilla kanë çuar në rritjen e kostos së punëve, duke paguar më shumë për diferencat në kualifikimin e ofertuesve, pa arritur efektivitet ekonomik në realizimin e prokurimit.

Nnuk kanë botuar njoftimin e lidhjes së kontratës në Buletinin e Njoftimeve Publike, në kundërshtim me kreun e parë, pika 3, germa “ç” Botimi i njoftimit të fituesit dhe njoftimi i kontratës së lidhur të VKM-së nr. 1, datë 10.01.2007.

6. R.Gj. në cilësinë e kryetares së Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

7. E.Gj. në cilësinë e kryetarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

8. Th.K. në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

9. P.H. në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

10. A.T. në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave

11. T.S. në cilësinë e anëtarit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave.

Për arsye se:

Anulimi i procedurave të hapura është bërë në mënyrë subjektive nga KVO për të kaluar në procedurën me negociim, pasi në procedurat e hapura janë paraqitur oferta, të cilat janë skualifikuar, për shkak të gabimeve të bëra në dokumentet e tenderit dhe veprimeve të autoritetit kontraktor, i cili nuk ka marrë masat e nevojshme për të korrigjuar veprimet, që shkaktuan dështimin e procedurave të hapura, për rrjedhojë në procedurat e prokurimit të zhvilluara gjatë viteve 2012, 2013 është konstatuar mungesë efektiviteti dhe economiciteti në përdorimin e fondeve publike të vëna në dispozicion të njësisë vendore në vlerën 14,191,222 lekë.

Në dhjetë raste zgjedhja e procedurës së prokurimit “me negociim pa shpallje të njoftimit të kontratës”, është bërë në kundërshtim me ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” neni 33 “Procedura me negociim, pa shpallje paraprake të njoftimit” dhe VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, kreu IV, pika 5, për arsye se dështimi i procedurave të hapura në të gjitha rastet ka rezultuar për shkak të kriterëve të veçanta për kualifikim të cilat nuk janë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe kanë çuar në s`kualifikimin e operatorëve ekonomik për mosplotësim të këtyre kriterëve. Këto kriterë nuk janë plotësuar nga operatorët ekonomik në asnjë rast në procedurat me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës dhe autoriteti kontraktor i ka shpallur fitues dhe ka nënshkruar kontrata madje me çmime më të larta se çmimet e ofruara në procedurat e hapura, duke favorizuar operatorë ekonomik/ofertues të caktuar në procedurat me negociim.

Kanë shqyrtuar ofertat e paraqitura nga operatorët ekonomik në tenderat e zhvilluara për periudhën vitet 2012, 2013, në kundërshtim me ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin

publik”, i ndryshuar, neni 53 “shqyrtimi i ofertave”, VKM nr. 1, datë 10.01.2007 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar kreu V “zhvillimi i procedurave”, duke kualifikuar ofertues të cilët nuk plotësojnë kriteret për kualifikim ose duke skualifikuar ofertues të cilët i plotësojnë kriteret e kualifikimit të përcaktuara nga autoriteti kontraktor në DST, si dhe ka përdorur dy standarde gjatë vlerësimit të ofertave.

D.I MASA ADMINISTRATIVE

1. Nga Bashkia Sarandë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 , t’i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë në vlerën 500,000 për K.K.** nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve dhe kolaudatorit, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderave me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **4.934.073 lekë pa T.V.SH**, më konkretisht në tenderat me objekt:

Nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve

“Rikonstruksion rrugësh, shtrim, ndriçim në pjesën e sipërme të qytetit, Lagja 3”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik të njësisë vendore në shumën 143.820 lekë pa T.V.SH, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punime të pakryera;

“Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me ujë për komunitetin (emergjenca)”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik të njësisë vendore në shumën 774.664 lekë pa T.V.SH, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punime të pakryera;

veprime në papajtueshmëri me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”

Nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve:

“Rikonstruksion dhe kthim në identitet të terreneve sportive të stadiumit të lojërave me dorë”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik të njësisë vendore në shumën 1.927.328 lekë pa T.V.SH, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punime të pakryera;

“Rikonstruksioni i varrezave të dëshmorëve”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik të njësisë vendore në shumën 1.127.750 lekë pa T.V.SH, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punime të pakryera;

veprime në papajtueshmëri me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe me udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3.

-Për mangësi në dokumentacion në kundërshtim me UKM nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të KM “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”” në 4 raste në investimet:

“Restaurimi dhe ndërtimi i ambienteve në funksion të Zadrës së notit, faza II”

“Rikonstruksion rrugësh, shtrim, ndriçim në pjesën e sipërme të qytetit, Lagja 3”

“Rikonstruksion Rruga hyrëse nr. 2 Berdenesh”

“Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me ujë për komunitetin (emergjenca)”

2. Bashkia Sarandë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III “Sanksionet”, nenet

15 e 16, t'i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë për P.K.** nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderit me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale prej **1.927.328 lekë pa T.V.SH**, më konkretisht në tenderin me objekt:

“Rikonstruksion dhe kthim në identitet të terreneve sportive të stadiumit të lojërave me dorë” me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik të njësisë vendore në shumën 1.927.328 lekë pa T.V.SH, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punime të pakryera; veprime në papajtueshmëri me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*

3. Bashkia Sarandë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 , t'i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë për D.B.** nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderit me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **1.127.750 lekë pa T.V.SH**, më konkretisht në tenderin me objekt:

“Rikonstruksioni i varrezave të dëshmorëve” me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik të njësisë vendore në shumën 1.127.750 lekë pa T.V.SH, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punime të pakryera; veprime në papajtueshmëri me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*

Për mangësi në dokumentacion në kundërshtim me UKM nr.1, datë 16.06.2011 *“Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*” në 1 rast në procedurat e zbatimit të investimit:

“Rikonstruksioni i varrezave të dëshmorëve”

4. Nga bashkia Sarandë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 *“Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”* i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 , t'i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë për M.Ç.** për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderave me pasojë dëm ekonomik ndaj buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **967.638 lekë pa T.V.SH**, më konkretisht në tenderin me objekt:

Nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve:

“Restaurim e rritje e performancës së lulishtes Hasan Tahsini” me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik të njësisë vendore në shumën 130.755 lekë pa T.V.SH, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punime të pakryera; veprime në papajtueshmëri me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 *“Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”*

-Për mangësi në dokumentacion në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr.1, datë 16.06.2011 *“Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”*” në 1 rast në procedurat e zbatimit të investimit:

“Restaurim e rritje e performancës së lulishtes Hasan Tahsini”

Nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve:

“Përmirësimi i rrjetit të furnizimit me ujë për komunitetin (emergjenca)”, me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik të njësisë vendore në shumën 774.664 lekë pa T.V.SH, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punime të pakryera;

veprime në papajtueshmëri me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe me udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3.

5. Nga bashkia Sarandë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 , t’i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë për F.M.** nën cilësinë e mbikëqyrësit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderit me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **130.755 lekë pa T.V.SH**, më konkretisht në tenderin me objekt:

- “Rikonstruktion, shtrim rruge blloku i banimit Limion, Lagjja 3” me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik të njësisë vendore në shumën 130.755 lekë pa T.V.SH, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punime të pakryera; veprime në papajtueshmëri me nenin 7 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit”

-Për mangësi në dokumentacion në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”” në 1 rast në procedurat e zbatimit të investimit:

- “Rikonstruktion, shtrim rruge blloku i banimit Limion, Lagjja 3”

6. Nga bashkia Sarandë të merren masa që në mbështetje të ligjit nr. 8402 dt. 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” i ndryshuar, Kreu III, nenet 15 e 16 , t’i kërkojë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor, **të vendosë masë administrative me gjobë për S.D.** nën cilësinë e kolaudatorit të punimeve, për shkeljet e konstatuara në procedurat e zbatimit të tenderit me pasojë dëm ekonomik ndajë buxhetit të njësisë vendore në vlerë totale **192.974 lekë pa T.V.SH**, më konkretisht në tenderin me objekt:

“Restaurim e rritje e performancës së lulishtes Hasan Tahsini” me pasojë shkaktimin e dëmit ekonomik të njësisë vendore në shumën 130.755 lekë pa T.V.SH, e cila përfaqëson pagesa të përfituara për punime të pakryera; veprime në papajtueshmëri me nenin 12 të ligjit nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për Kontrollin dhe Disiplinimin e Punimeve të Ndërtimit” dhe me udhëzimin nr. 3 datë 15.02.2001 “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”, Kreu II, Pika 3.

-Për mangësi në dokumentacion në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr.1, datë 16.06.2011 “Për disa ndryshime në udhëzimin nr.3, datë 15.2.2001 të Këshillit të Ministrave “Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit”” në 1 rast në procedurat e zbatimit të investimit:

“Restaurim e rritje e performancës së lulishtes Hasan Tahsini”.

Nga Bashkia Sarandë me shkresë nr.2000/3, prot, datë 17.10.2014, protokolluar në KLSH me nr.454/11 datë 23.10.2014, është kthyer përgjigje së bashku me planin e masave për zbatimin e rekomandimeve të dërguara nga KLSH, **pra rezulton se rekomandimet janë pranuar dhe zbatuar pjesërisht.**

Me ndjekjen dhe kontrollin e zbatimit të detyrave dhe masave të përcaktuara në këtë vendim ngarkohet Departamenti i Auditimit të Buxhetit të Pushtetit Vendor, Kontrollit të Territorit dhe Administrimit të Aseteve të Qëndrueshme.

Shënim: Auditimi është kryer nga audituesit Ramadan Zejnunit, Piro Imeraj, Sotir Kosdine, Ryisim Xhaja, Shefki Jaupaj dhe Jonild Hoxhaj më tej u shqyrtua nga z. Niko Nako kryeauditues, z. Bajram

Lamaj Drejtor i Departamentit, z. Ermal Yzeiraj, Drejtor i Drejtorisë Juridike, Kontrollit të Cilësisë dhe Analizës së Riskut, si dhe u verifikua si praktikë nga znj. Helga Vukaj, Drejtor i Përgjithshëm.

KONTROLLI I LARTË I SHTETIT